



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-(SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)
Hospitaland University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)

Raport i Punës Janar-Dhjetor 2025

Prishtinë
Janar, 2026



Tabela e Shkurtesave

Shkurtesa	Përshkrimi
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
BD	Bordi Drejtues
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKUSK	Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës
QKMP	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Punës
QKMS	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
QKTK	Qendra Kombëtare e Telemjekësisë së Kosovës
SP	Spitali i Përgjithshëm
QSHMSHIB	Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi
QIRSKP	Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik
BQ	Barnatorja Qëndrore
BOR	Shfrytëzueshmëria e shtretërve (Një përqindje që tregon shfrytëzimin mesatar të shtretërve). Indikator i cili tregon efikasitetin dhe efektivitetin e shfrytëzimit të resurseve në dispozicion të njësisë spitalore.
ALOS	Kohëzgjatja e qëndrimit të pacientëve - Një mesatare e ditëve të qëndrimit të pacientëve në spitale. Indikator i cili e matë efikasitetin dhe efektivitetin së shërbimit shëndetësor të ofruar për pacient në njësinë spitalore.
Numri i vizitave ambulatorie	Numri i vizitave mjekësore që nuk kërkojnë shtrim në spital
Numri i Tomografive të Kompjuterizuara (CT)	Procedura të imazherisë të realizuara për diagnostikim
Rezonanca Magnetike (MRI)	Procedura të imazhërisë të realizuara për diagnostikim

**Përmbajtja:**

Fjala hyrëse e Bordit Drejtues.....	4
Përmbledhja Ekzekutive.....	5
1. Shërbimet shëndetësore të ofruara në SHSKUK.....	6
1.1. Shfrytëzueshmëria dhe Kohëzgjatja e Qëndrimit.....	7
1.2. Vizitat dhe Procedurat Diagnostikuese.....	7
1.3. Procedurat Kirurgjikale dhe Laboratorike.....	8
1.4. Shërbime të Specializuara.....	8
1.5. Shërbimet Obstetrike dhe Dializa.....	9
1.6. Statistika të Pacientëve.....	9
2. Shërbimet e ofruara në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).....	10
2.1 Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Klinikat Kirurgjikë në QKUK.....	12
2.2. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Klinikat Internistike në QKUK.....	23
2.3. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Klinikat Diagnostike në QKUK.....	32
3. Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës (QKSUK).....	38
4. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Spitalet e Përgjithshme në SHSKUK.....	40
4.1. Efikasiteti i Shërbimeve.....	41
4.2. Cilësia e Shërbimeve.....	44
4.3. Shërbimet e ofruara sipas Spitaleve të Përgjithshme.....	46
5. Qendrat e shëndetit mendor me Shtëpi Integruese në Bashkesi dhe QIRSKP Shtime.....	57
6. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës (QKMP) Gjakovë	58
7. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive (QKMS).....	59
8. Poliklinikat Specialistike e Podujeves.....	60
9. Menaxhimi Financiar.....	61
10. Furnizimi me barëra dhe material shpenzues.....	62
11. Donacionet.....	63
12. Shërbimet e reja dhe të konsoliduara 2025.....	65
Aneks: Krahasimi i shërbimeve të ofruara 2020-2025.....	68

Fjala Hyrëse

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) përbën një nga institucionet publike më të mëdha në vend dhe është ofruesi kryesor i shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Republikës së Kosovës. Me një rol thelbësor në sistemin shëndetësor të vendit, ShSKUK është i përkushtuar në sigurimin e kujdesit shëndetësor dytësor dhe tretësor, në përputhje me standardet bashkëkohore profesionale.

Në këtë kuadër, shtatë spitalet e përgjithshme ofrojnë kujdesin dytësor, ndërsa Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) dhe Qendra Stomatologjike Klinike Universitare e Kosovës (QKSUK) përbëjnë shtyllat kryesore të kujdesit tretësor në vend.

Duke u mbështetur në standardet profesionale bashkëkohore, misioni dhe vizioni i Bordit Drejtues është që ShSKUK të jetë institucion lider në vend për nga cilësia dhe siguria në kujdesin shëndetësor, duke ofruar shërbime të qasshme për të gjithë qytetarët me kosto të arsyeshme. Synimi ynë është ndërtimi i një sistemi shëndetësor të bazuar në efikasitet, transparencë dhe besim publik. Ky përkushtim promovohet vazhdimisht në të gjitha njësitë përbërëse të ShSKUK-së, me qëllim që shërbimet e ofruara të reflektojnë nevojat reale të qytetarëve.

Mungesa e të dhënave të bazuara në evidencë nga njësitë përbërëse ka qenë një nga sfidat kryesore të institucionit. Kjo mangësi ka kufizuar mundësinë për planifikim të saktë dhe për ngritje të kapaciteteve infrastrukturore e burimeve njerëzore, në përputhje me kërkesat reale për shërbime shëndetësore.

Për të adresuar këtë sfidë, Bordi Drejtues është angazhuar në hartimin e një Raporti të Unifikuar dhe të Standardizuar për të gjitha njësitë përbërëse të ShSKUK-së, të ndërtuar mbi indikatorë kyç të performancës. Ky raport paraqet një pasqyrë të qartë të situatës aktuale dhe njëkohësisht shërben si udhërrëfyes për zhvillimin e ardhshëm të institucionit. Nëpërmjet kësaj qasjeje synohet identifikimi më i saktë i sfidave dhe adresimi efektiv i nevojave prioritare.

Kjo përpjekje për standardizim dhe për mbështetje të vendimmarrjes në të dhëna të bazuara në evidencë përfaqëson një hap të rëndësishëm në një proces të vazhdueshëm përmirësimi, i cili do të plotësohet dhe zhvillohet me kalimin e kohës, duke u përshtatur me dinamikën dhe natyrën e punës në të gjitha njësitë përbërëse të ShSKUK-së.

Ne besojmë se ky raport do të shërbejë si një dritare e re për të kuptuar gjendjen reale dhe si një bazë e qëndrueshme për vendimmarrje strategjike efikase, duke u mundësuar institucioneve shëndetësore të ofrojnë shërbime të sigurt, cilësore, të qëndrueshme dhe kosto-efektive për qytetarët e Kosovës.

Me këtë, kemi hapur një kapitull të ri në menaxhimin dhe zhvillimin e ShSKUK-së, duke siguruar që ky Institucion të vazhdojë të përmbushë rolin e tij të përcaktuar me ligj dhe statut në mënyrën më efektive të mundshme.

Bordi Drejtues i ShSKUK-së



Përmbledhja Ekzekutive

Gjatë vitit 2025, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK) ka shënuar performancë të qëndrueshme dhe progres të vazhdueshëm në përmbushjen e misionit të tij për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore, të qasshme dhe të sigurta për qytetarët e Republikës së Kosovës. Përveç avancimit të ofrimit të shërbimeve klinike, gjatë këtij viti është realizuar edhe një angazhim i konsiderueshëm në fuqizimin institucional, konsolidimin e strukturave menaxheriale dhe përmirësimin e organizimit të brendshëm.

Në aspektin e performancës spitalore, shfrytëzueshmëria mesatare e shtretërve (BOR) në nivel të SHSKUK gjatë vitit 2025 ka qenë **60%**, me QKUK që ka realizuar **74%**, ndërsa spitalet e përgjithshme rreth **48%**. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të pacientëve (ALOS) ka qenë **4.53 ditë**. Gjatë vitit janë trajtuar **167,439 pacientë të shtrirë**, me gjithsej **775,845 ditë shërimi** të realizuara. Norma e vdekshmërisë spitalore ka qenë **2%**, me gjithsej **3,276 raste**.

Në nivel të shërbimeve ambulatorë dhe diagnostike, gjatë vitit 2025 në SHSKUK janë realizuar gjithsej **1,805,700 vizita ambulatorë**. Janë kryer **56,727** ekzaminime me Tomografi të Kompjuterizuar (CT), **21,937** Rezonanca Magnetike (MRI), **226,405** Radiografi (RTG), **171,870** EKG, **6,521** EEG, si dhe **5,087,044** parametra laboratorike. Po ashtu janë realizuar 21 316 ekokardiografi, 3 955 teste të stresit (treadmill) dhe **1,438** Holter kardiak.

Në fushën e ndërhyrjeve dhe procedurave invazive, gjatë vitit 2025 janë kryer gjithsej **46,291 operacione kirurgjikale**, **4,535 koronarografi** dhe janë vendosur **4,006 stente**. Janë realizuar gjithashtu **119,564 seanca dialize**. Gjatë vitit janë evidentuar **16,923 lindje**, nga të cilat **40%** janë realizuar me prerje cezariene.

Këto rezultate dëshmojnë për një volum shumë të lartë të punës klinike dhe diagnostike në të gjitha nivelet e SHSKUK-së, si dhe për rolin qendror të QKUK-së dhe spitaleve të përgjithshme në mbulimin e nevojave shëndetësore të popullatës.

Paralelisht me performancën klinike, gjatë vitit 2025 SHSKUK ka realizuar edhe një sërë zhvillimesh të rëndësishme menaxheriale dhe organizative. Është avancuar struktura e brendshme organizative, janë fuqizuar mekanizmat e planifikimit dhe monitorimit të performancës, është përmirësuar menaxhimi i burimeve njerëzore dhe janë realizuar investime të rëndësishme në pajisje dhe aparaturë mjekësore, me qëllim rritjen e kapaciteteve diagnostike dhe terapeutike.

Gjithashtu, gjatë vitit janë zhvilluar bashkëpunime të shumta me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi dhe janë intensifikuar aktivitetet në fushën e trajnimeve profesionale dhe zhvillimit të kapaciteteve.

Në tërësi, viti 2025 karakterizohet nga një performancë e qëndrueshme klinike dhe organizative e SHSKUK-së, me rritje të vazhdueshme të volumit të shërbimeve, konsolidim të strukturave menaxheriale dhe me një rol gjithnjë e më të fuqishëm në garantimin e qasjes së barabartë dhe cilësore të qytetarëve në shërbimet shëndetësore publike.

Elvir Azizi
Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK



1. Shërbimet shëndetësore të ofruara në SHSKUK


Shërbimet shëndetësore që ofrohen në SHSKUK janë të shumëllojshme dhe të orientuara për të ofruar kujdes të plotë dhe të specilizuar për pacientët duke filluar nga diagnostifikimi, trajtimi dhe deri te rehabilitimi.

Shërbimet e ofruara në SHSKUK									
Indikatoret kyç te performancës	QKUK	Spitalet e pergjithshme	QSKUK	QKMS	QKMP Gjakove	QSHMBI	QIRSKP- Shtime	Poliklinika Podujev	Gjithsej
BOR (shfrytëzueshmëria e shtretëve)	74%	48%					98%		60%
ALOS (kohëzgjatja e qëndrimit të pacientit/ës në spital)	5.1	3.9							4.53
Vizita ambulantore	715249	934718	71887	21368	32974	28919	585	4019	1805700
Tomografi e Kompjuterizuar (CT-ja)	30694	26033							56727
Mamografi	1370	3280							4650
Ultrazë (numri total i ofruar ne te gjitha repartet)	111070	129973			301				241344
EKG (numri total i ofruar ne te gjitha repartet)	33043	138827							171870
Elektroencefalografia (EMNG-ja)	2666	561							3227
Electroencefalografia (EEG-ja)	5390	1131							6521
Operacione (numri total i ofruar ne te gjitha repartet)	26767	18210	1314						46291
Rentegen (RTG-ja)	85602	118015	18794		3994				226405
Rezonanca Magnetike (MRI)	16938	4999							21937
Laborator (Parametrat laboratorik)	2026754	2956655			103635				5087044
Ekokardiografi	10088	11228							21316
Stress Test (tredmil)	1832	2001		122					3955
Holter kardiak	996	442							1438
Koronarografi	3845	690							4535
Stentime	3805	201							4006
Femijet e lindur	7544	9563							17107
Numri i lindjeve	7458	9465							16923
Lindjet me CS	3074	3715							6789
% e lindjeve me CS	41%	39%							40%
Dializa	36165	81749						1650	119564
Numri i pacienteve te shtrire	88133	79241					65		167439
Ditet e sherimit	449576	309170					17099		775845
Nr i vdekjeve	1723	1553							3276
% e te vdekurve ne raport me numrin e te shtrireve	2%	2%							2%
Aktivitete tjera			181412			84515.5	668		266595.5

Shërbimet Shëndetësore për periudhën janar-dhjetor 2025 përmbajnë treguesit kyç të performancës për shërbimet e ofruara në institucione të ndryshme shëndetësore të Kosovës, përfshirë Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe spitalet e tjera të përgjithshme dhe njësitë tjera përbërëse të ShSKUK. Disa nga treguesit kryesorë përfshijnë:

1.1. Shfrytëzueshmëria dhe Kohëzgjatja e Qëndrimit në njësitë përbërëse të SHSKUK

- **Shfrytëzueshmëria e shtretërve (BOR):** Mesatarisht, shfrytëzimi i shtretërve në SHSKUK është **60%**, me QKUK që ka një normë më të lartë prej 74% dhe spitalet e përgjithshme 48%.
- **Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në spital (ALOS):** Pacientët qëndrojnë mesatarisht 4.5 ditë në SHSKUK, me QKUK që ka kohëzgjatjen më të lartë prej 5.1 ditë dhe në spitalet me 3.9 ditë.




1.2. Vizitat dhe Procedurat Diagnostikuese

- **Vizitat Ambulatorore:** Gjatë vitit 2025, në nivel të SHSKUK janë realizuar gjithsej 1,805,700 vizita ambulatorore. Nga ky numër, QKUK ka realizuar 715,249 vizita, që përbëjnë rreth 39.2% të totalit. Spitalet e përgjithshme kanë realizuar 934,718 vizita, apo rreth 52.2% të totalit, duke mbajtur barrën kryesore të fluksit ambulator. Ndërsa njësitë e tjera kanë kontribuar si në vijim: QSKUK me 71,887 vizita (3.9%), QKMS me 21,368 vizita (1.2%), QKMP Gjakovë me 32,974 vizita (1.8%), QSHMBI me 28,919 vizita (1.4%), QIRSKP Shtime me 585 vizita (0.03%) dhe Poliklinika e Podujevës me 4,019 vizita (0.2%).
- **Tomografi e Kompjuterizuar (CT):** Gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej 56,727 ekzaminime me Tomografi të Kompjuterizuar (CT). Prej tyre, QKUK ka realizuar 30,694 ekzaminime, që përbëjnë rreth 54.1% të totalit, ndërsa spitalet e përgjithshme kanë realizuar 26,033 ekzaminime, apo rreth 45.9% të totalit.
- **MRI:** Janë realizuar 21,937 ekzaminime, nga të cilat 77.2% në QKUK dhe 22.8% në spitalet e përgjithshme.
- **Ultrazë:** Janë realizuar **241,344 ekzaminime**, prej të cilave **53.9%** në spitalet e përgjithshme dhe **46.0%** në QKUK.
- **EKG (Elektrokardiogramë):** Janë kryer **171,870 EKG**, ku **80.8%** janë realizuar në spitalet e përgjithshme dhe **19.2%** në QKUK.
- **EMNG (Elektromiografi):** Janë realizuar **3,227 ekzaminime**, prej të cilave **82.6%** në QKUK dhe **17.4%** në spitalet e përgjithshme.
- **EEG (Elektroencefalografi):** Janë kryer **6,521 ekzaminime**, ku **82.7%** janë realizuar në QKUK dhe **17.3%** në spitalet e përgjithshme.
- **RTG:** Janë kryer **226,405 ekzaminime**, ku **52.1%** janë realizuar në spitalet e përgjithshme dhe **37.8%** në QKUK.
- **Parametra Laboratorik:** Janë realizuar **5,087,044 analiza**, prej të cilave **58.1%** në spitalet e përgjithshme dhe **40.6%** në QKUK.

1.3. Procedurat Kirurgjikale

- **Operacione:** Gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej **46,291 operime kirurgjike** në SHSKUK, prej të cilave **26,767 (57.8%)** në QKUK, **18,210 (39.3%)** në spitalet e përgjithshme dhe **1,314 (2.8%)** në QSKUK.




1.4. Shërbime të Specializuara

- **Ekokardiografi:** Janë kryer 21,316 ekzaminime, ku 52.7% në spitalet e përgjithshme dhe 47.3% në QKUK.
- **Testet e Stresit (Treadmil):** Gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej **3,955 teste Treadmill**, prej të cilave 1 832 në QKUK (46.3%) dhe **2001** në spitalet e përgjithshme (50.5%) dhe 122 (3%) teste ne QKMS.
- **Holter Kardiak:** Në vitin 2025 janë realizuar gjithsej 1,438 ekzaminime Holter, prej të cilave 996 në QKUK (69%) dhe 442 në spitalet e përgjithshme (31%).
- **Koronarografi:** Janë realizuar 4,535 procedura, prej të cilave 84.8% në QKUK dhe 15.2% në spitalet e përgjithshme. (**Spitali i Prizrenit**).
- **Stent:** Gjatë vitit 2025 janë vendosur gjithsej 4,006 stente në SHSKUK, prej të cilave 3,805(95%) në QKUK dhe 201 (5%) në Spital te Prizreni.

1.5. Shërbimet Obstetrike dhe Dializa


Gjatë vitit 2025, në kuadër të SHSKUK janë realizuar gjithsej 16,923 lindje, me gjithsej 17,107 foshnje të lindura, çka tregon se një pjesë e lindjeve kanë qenë me binjakë apo lindje multiple. Nga totali i lindjeve, 6,789 janë kryer me prerje cezariene, që përbëjnë rreth 40% të të gjitha lindjeve, duke reflektuar një nivel relativisht të lartë të ndërhyrjeve operative obstetrike. Spitalet e përgjithshme, të cilat kanë realizuar 9,465 lindje, krahasuar me 7,458 lindje në QKUK.



Sa i përket dializës, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej 119,564 seanca dialize, prej të cilave 81,749 janë kryer në spitalet e përgjithshme, ndërsa 36,165 në QKUK. Kjo tregon se mbi dy të tretat e shërbimit të dializës ofrohen në nivelin dytësor, duke dëshmuar decentralizimin e këtij shërbimi dhe rolin kyç të spitaleve rajonale në menaxhimin e pacientëve kronikë me insuficiencë renale.

1.6. Statistika të Pacientëve

- Gjatë vitit 2025, në kuadër të SHSKUK janë realizuar gjithsej 775,845 ditë shërimi, prej të cilave 449,576 ditë (48%) në QKUK dhe 309,170 ditë (40%) në spitalet e përgjithshme, dhe 17,099 ditë shërimi tek QIRSKP Shtime duke reflektuar ngarkesën më të madhe të trajtimit spitalor në nivelin terciar.
- Në të njëjtën periudhë, janë trajtuar gjithsej 167,439 pacientë të shtrirë, nga të cilët 88,133 pacientë (53%) në QKUK dhe 79,241 pacientë (47%) në spitalet e përgjithshme.



2. Shërbimet e ofruara në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK)

QKUK, ofron shërbime të nivelit dytësor dhe tretësor të shërbimeve publike shëndetësore në Republikën e Kosovës. Këto shërbime shëndetësore ofrohen nga 38 njësi të ndara në klinika dhe shërbime.

Tabela e më poshtme do të shfaq përmbledhjen e shërbimeve shëndetësore të ofruara në 38 njësi të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës.

Njësitë e QKUK	Shifr i kapaciteteve	Sherimi	Nr. të shtrirëve	Ditë shërimi	Nr. të operuarve	Vizita ambulantore dhe specialistike	Shërbime diagnostike dhe radiologjike	Shërbime laboratorike	Shërbime tjera/apo te vecanta
Klinika Obstetrike Gjinekologjike	64%	2.4	27,606	65,739	4,024	70,331	65,016		78,098
Klinika e Dermatovenerologjisë	69%	6.1	1,240	7,560		24,522	2,023		11,350
Klinika e Kirurgjisë Abdominale	73%	5.7	3,084	17,657	2,578	13,455	6,063		
Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale	61%	6.6	700	4,641	1,081	3,908			2,669
Klinika Ortopedisë dhe Traumatologjisë	65%	7.5	2,728	20,403	2,274	29,797	913		8,399
Klinika e Kirurgjisë Torakale	78%	6.9	989	6,819	740	3,444	492		900
Klinika e Gastroenterologjisë	83%	8.4	1,184	9,993		10,569	6,006		3,611
Klinika e Hematologjisë	54%	5.7	736	4,159		9,913	1,352		7,366
Klinika e Neonatologjisë	60%	3.7	8,208	30,706		5,125	2,118		1,521
Klinika Infektive	72%	10.3	3,053	31,373		19,809	712		
Klinika e Syve	99%	5.1	4,114	21,050	4,465	46,943	8,925		1,193
Klinika e Nefrologjisë	100%	7.3	1,072	7,856		8,961	3,616		37,597
Klinika e Pulmologjisë	89%	12.4	1,724	21,431		15,465	5,911		1,855
Klinika e Kardiologjisë	97%	3.5	7,445	26,423		22,110	31,514		6,455
Klinika e Pediatriisë	79%	5.5	7,937	43,725		65,463	9,036		5,820
Klinika e Endokrinologjisë	56%	8.5	770	6,514		18,689	5,106		26,964
Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimi Intensiv	93%	17.5	978	10,003		131,023			21,029
Klinika e ORL-së	94%	14.6	1,505	22,011	1,505	26,580	4,253		7,118
Klinika e Neurologjisë	83%	7.2	2,072	14,826		17,433	9,400		6,419
Klinika e Biokimisë Mjekësore								1,988,538	
Shërbimi Klinik Emergjent						24,456			
Klinika e Mjekësisë Fizikale dhe Rehabilitim	64%	16.4	358	5,863		12,204	521		75,442
Klinika e Kirurgjisë Plastike	60%	4.9	936	4,601	2,264	9,434			10,353
Klinika e Neurokirurgjisë	74%	6.2	1,044	6,477	832	4,648	831		2,980
Klinika e Urologjisë	65%	3.4	1,560	5,260	3,706	8,126	1,740		
Klinika e Onkologjisë	63%	9.4	270	2,549		60,246			111,698
Klinika e Kardiokirurgjisë	96%	11.9	505	5,986	414	1,415	7,418		2,827
Klinika e Psikiatriisë	58%	21.3	626	13,360		14,263	2,555		7,133
Klinika e Radiologjisë							162,724		
Klinika e Reumatologjisë	86%	6.9	1,149	7,882		9,398	3,511		287
Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve	61%	2.6	1,683	4,417	1,293	9,336	1,675		
Klinika Kirurgji Vaskulare	75%	3.5	1,880	6,593	1,591	8,795	2,621		3,865
Klinika e Alergologjisë me Imunologji	64%	3.9	483	1,870		6,115	554		
Instituti i Psikiatriisë Forenzike	90%	23.9	494	11,829		1,164	408		
Instituti i Paraklinike							24,643		
Shërbimi i Mjekësisë Nukleare						752	9,462		
Shërbimi i Mikrobiologjisë Klinike								38,216	
Shërbimi i Ortoprotetikës						1357			1,443
Total	74%	5.1	88,066	448,939	26,767	715,249	381,119	2,026,754	444,392



Përmbledhje Ekzekutive për Shërbimet Klinike në QKUK

- Kapacitetet e Shfrytëzuara dhe Ditët e Shërimit, Mesatarja e shfrytëzueshmërisë: 74% dhe Mesatarja e ditëve të shërimit: 5.1 ditë
- Numri total i pacientëve të shtrirë gjatë periudhës raportuese ishte 88,066.
- Numri total i ditëve të qëndrimit në spital arriti në 448,939 ditë.
- Janë realizuar gjithsej 26,767 ndërhyrje kirurgjikale në klinikat përkatëse.
- Janë regjistruar gjithsej 715,249 vizita ambulatorë dhe specialistike.

Klinikat me numrin më të lartë të pacientëve të shtrirë:

- Klinika Obstetrike Gjinekologjike: 27,739 të shtrirë
- Klinika e Neonatologjisë: 8,208 të shtrirë
- Klinika e Pediatrisë: 7,934 të shtrirë

Klinikat me më së shumti ndërhyrje kirurgjikale:

- Klinika e Syve: 4,465 operacione
- Klinika Obstetrike Gjinekologjike: 4,024 operacione
- Klinika e Kirurgjisë Abdominale: 2,578 operacione
- Klinika e Urologjisë: 3,706 operime

Vizitat Ambulatorë dhe Specialistike

Totali i vizitave ambulatorë dhe specialistike të realizuara: **715,249**

Klinikat me numrin më të lartë të vizitave:

- Klinika e Onkologjisë – **60,246**
- Klinika e Pediatrisë – **65,463**
- Klinika e Syve – **46,943**
- Klinika e Kardiologjisë – **22,110**
- Klinika e Dermatovenerologjisë – **24,522**
- Klinika e Endokrinologjisë – **18,689**
- **Klinika e Gjinekologjisë: 70,331**

Shërbimet Diagnostike dhe Radiologjike

Totali i shërbimeve diagnostike dhe radiologjike në QKUK për këtë periudhë pune është: 381,119.

Klinikat me numrin më të lartë të shërbimit të ofruar është:

- Klinika e Radiologjisë – 162,724
- Klinika e Gjinekologjisë me Obstetrikë- 65,016



- Klinika e Kardilogjisë-31,514
- Institutet Paraklinike-24,643

2.2. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Klinikat Kirurgjike në QKUK

Efikasiteti dhe Cilësia e Shërbimeve të Klinikat Kirurgjike

Njësitë e QKUK	Shfrytëzimi i Kapaciteteve	Kohëzgjatja e trajtimit
Klinika Obstetrike Gjinekologjike	64%	2.4
Klinika e Kirurgjisë Abdominale	73%	6.1
Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale	61%	6.6
Klinika Ortopedisë dhe Traumatologjisë	65%	7.5
Klinika e Kirurgjisë Torakale	78%	6.9
Klinika e Syve	99%	5.1
Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimi Intensiv	93%	16.4
Klinika e ORL-së	94%	14.6
Klinika e Kirurgjisë Plastike	60%	4.9
Klinika e Neurokirurgjisë	74%	6.2
Klinika e Urologjisë	48%	3.4
Klinika e Kardiokirurgjisë	96%	11.9
Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve	61%	2.6
Klinika Kirurgji Vaskulare	75%	3.5

Shfrytëzimi i lartë i kapaciteteve: Klinikat e Syve (99%) dhe Klinika e Anestezionit dhe Mjekimit Intenziv (93%) tregojnë një shfrytëzim shumë të mirë të resurseve të tyre, te cilet kanë menaxhim efikas të kapaciteteve.

Kohëzgjatja e shkurtër e trajtimit: Klinikat si ajo Obstetrike Gjinekologjike (2.4 ditë) dhe e Kirurgjisë së Fëmijëve (2.4 ditë) kanë një kohëzgjatje të trajtimit relativisht të shkurtër, duke treguar efikasitet në shërbim dhe kthim të shpejtë të pacientëve.

Efikasiteti i Operacioneve Kirurgjike: Total numri i operacioneve: **26,767**

KLINIKA	NR. TË OPERUARVE
KLINIKA E SYVE	4,465
KLINIKA OBSTETRIKE GJINEKOLOGJIKE	4,024
KIRURGJIA ABDOMINALE	2,578
KLINIKA E ORTOPEDISË	2,274
KLINIKA E KIRURGJISE PLASTIKE	2,264
KIRURGJIA E UROLOGJISE	3,706



Numri i Operacioneve: Klinika e Syve dhe Klinika Obstetrike Gjinekologjike kryesojnë për numrin më të madh të operacioneve, që tregojnë për një ngarkesë të lartë kirurgjikale në këto klinika.

Klinika Obstetrike Gjinekologjike ka kryer një numër të madh operimesh (4,024), duke treguar për një kapacitet të lartë operativ dhe shërbime komplekse kirurgjikale të ofruara.

Klinika e Kirurgjisë Plastike, megjithëse ka një kapacitet relativisht më të vogël (21 shtretër), ka një numër të konsiderueshëm të operacioneve (2,264), që tregojnë efikasitet të lartë në ofrimin e shërbimeve kirurgjikale.

Klinika e Anestezionit dhe Mjekimit Intenziv, ka ofruar gjithsej 21,029 anestezi të përgjithshme.

Klinika Emërgjente

Klinika Emergjente e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka treguar performancë të lartë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, me një fluks të konsiderueshëm pacientësh dhe angazhim të fuqishëm të burimeve njerëzore.

Lloji i shërbimit	Totali vjetor	Mesatarja ditore
Vizita në reanimim	24,456	67
Vizita të pacientëve internistik	32,678	90
Vizita të pacientëve kirurgjik	18,147	50
Vizita të pacientëve ortopedik	21,795	60
Intervenime në sallën e vogël	6,794	19
Pacientë të operuar në sallën operative të Q. Emergjente	1,297	4
Pranime në njësitë përkatëse nga Q. Emergjente	10,282	28
Gjithsej vizita mjekësore në Q. Emergjente	103,870	285

Gjatë vitit 2025, Klinika Emergjente e QKUK ka trajtuar gjithsej **103,870 raste**, që i bie një mesatare prej rreth **285 pacientësh në ditë**, duke dëshmuar ngarkesë shumë të lartë dhe rol qendror në sistemin shëndetësor terciar. Në baza ditore, janë trajtuar mesatarisht rreth **90 pacientë internistikë**, **60 ortopedikë** dhe **50 kirurgjikë**, si dhe rreth **67 pacientë në reanimim**, çka tregon për një profil të rëndë dhe kompleks të rasteve.

Po ashtu, çdo ditë janë realizuar mesatarisht **19 intervenime në sallën e vogël**, **4 operime urgjente** dhe rreth **28 pacientë janë pranuar për hospitalizim** nga Emergjencia në klinikat përkatëse.

Klinika e Anestezionit dhe Mjekimit Intenziv

Nr	Përshkrimi	Vlera
1	Nr. i shtretërve – Total MIQ (P. Intenziv)	25
1.1	Nr. i pacientëve të shtrirë – MIQ	520
1.2	Gjatësia mesatare e qëndrimit – MIQ (ditë)	16.48



1.3	Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve – MIQ	93.93%
1.4	Nr. i shtretërve – Total MIK	10
1.5	Nr. i pacientëve të shtrirë – MIK	458
2	Ditë shërimi – MIK	1,432
2.1	Gjatësia mesatare e qëndrimit – MIK (ditë)	3.12
2.2	Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve – MIK	39.23%
2.3	Numri i anesteziioneve	21,029
2.4	Nr. i anesteziioneve për mjek	620
2.5	Vizita specialistike	131,023
3	Nr. i mjekëve specialistë	45
4	Nr. i infermierëve/ëve	181
5	Nr. i punonjësve të tjerë	13
6	Nr. i shtretërve – Gjysmë-Intensive Gjinekologji (KOGJ)	14
7	Nr. i pacientëve të shtrirë – KOGJ	4,098
8	Ditë shërimi – KOGJ	4,264
9	Gjatësia mesatare e qëndrimit – KOGJ (ditë)	1.04
9.1	Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve – KOGJ	83.44%
9.2	Nr. i pacientëve pre & post-operativ (19 shtretër)	6,580
9.3		

Gjatë vitit 2025, Njësia e Mjekimit Intensiv (MIQ) ka funksionuar me **25 shtretër** dhe ka trajtuar gjithsej **520 pacientë**, me **8,571 ditë shërimi** dhe një **kohëzgjatje mesatare të qëndrimit prej 16.48 ditësh**, çka tregon për trajtim të rasteve të rënda dhe komplekse. **Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve prej 93.93%.**

MIK, me **10 shtretër**, ka trajtuar **458 pacientë**, me **1,432 ditë shërimi** dhe një **kohëzgjatje mesatare të qëndrimit prej 3.12 ditësh**. **Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve prej 39.23%** tregon se kjo njësi ka kapacitete të pashfrytëzuara, ndonëse ka pasur një volum të konsiderueshëm pacientësh.

Në fushën e anesteziologjisë, gjatë vitit janë realizuar gjithsej **21,029 anesteziione**, me një ngarkesë mesatare prej rreth **620 anesteziione për mjek në vite**, çka dëshmon për një volum shumë të lartë pune operative dhe mbështetje intensive të sallave operative. Po ashtu janë realizuar **131,023 vizita specialistike**, duke reflektuar rol të gjerë konsultativ të këtij shërbimi në gjithë QKUK-ne.

Sa i përket burimeve njerëzore, shërbimi funksionon me **45 mjekë specialistë**, **181 infermierë/e** dhe **13 punonjës të tjerë**.

Në Njësinë Gjysmë-Intensive të Gjinekologjisë (KOGJ), me **14 shtretër**, janë trajtuar **4,098 pacientë**, me **4,264 ditë shërimi** dhe një **qëndrim mesatar prej 1.04 ditësh**. **Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve prej 83.44%** tregon për një ngarkesë të lartë dhe funksionim intensiv të kësaj njësie.

Përveç kësaj, në shtretërit për trajtim **pre dhe post-operativ** (Kirurgji, ORL, Maksillofaciale, Kirurgji Pediatrike dhe KOGJ), me gjithsej **19 shtretër**, janë trajtuar **6,580 pacientë**, çka tregon

për një fluks shumë të madh dhe rol kyç të këtyre kapaciteteve në mbështetjen e shërbimeve kirurgjikale.

Klinika e Kirurgjisë së Syve

FUSHA E AKTIVITETIT	INDIKATORI KRYESOR	TOTALI VJETOR
KAPACITETI SPITALOR	Nr. i shtretërve	58
	Pacientë të shtrirë	4,114
	Ditë shërimi	21,050
AKTIVITETI KIRURGJIKAL (TOTAL)	Ndërhyrje / shërbime operative	4,329
	Operime të kataraktës (PHACO)	2,661
	Pterygiume	151
	Operime të kanaleve të lotit (DCR/DCE)	138
	Operime antiglaukomoze	70
	Operime strabizmi	53
	Lëndime të syve	73
	Tumore okulare	48
PROCEDURA INTERVENUESE / TEKNOLOGJIKE	Aplikime intravitreale & intrakamerale (Anti-VEGF)	4,437
	YAG Laser	296
	Vitrektomi (PPV)	344
	Cross-Linking (XCL)	79
	Ex-Silicon	78
	Tomografi korneale	344
AKTIVITETI AMBULATOR & DIAGNOSTIK	Vizita ambulatorë & konsultative	46,943
	OCT	6,291
	ECHO okulare	784
	ROP	945
	Fusha vizive (Perimetri)	689
	Shërbime laboratorike	1,171
AKTIVITETE TË TJERA KLINIKE	LFK	291
	Komisioni Invalidor	270
	Trajtime jashtë vendit	178

Gjatë vitit 2025, klinika ka funksionuar me një kapacitet konstant prej 58 shtretërve gjatë gjithë vitit dhe ka trajtuar gjithsej 4,114 pacientë të shtrirë, me gjithsej 21,050 ditë shërimi, çka dëshmon për një ngarkesë të qëndrueshme dhe volum të lartë të punës spitalore. Paralelisht, janë realizuar gjithsej 4,329 ndërhyrje kirurgjikale dhe shërbime operative, duke reflektuar një aktivitet intensiv kirurgjikal gjatë gjithë vitit.

Në kuadër të aktivitetit kirurgjikal, dominon operimi i kataraktës me PHACO me gjithsej 2,661 ndërhyrje, që përbën shtyllën kryesore të punës operative të klinikës. Përveç kësaj, janë realizuar

151 operime të pterigiumit, 138 ndërhyrje në kanalet e lotit (DCR/DCE), 70 operime antiglaukumatoze, 53 operime të strabizmit, 73 ndërhyrje për lëndime të syve dhe 48 operime për tumore, duke dëshmuar një profil të gjerë dhe kompleks të shërbimeve kirurgjikale oftalmologjike.

Një volum shumë i lartë është evidentuar edhe në procedurat intervenuese dhe diagnostike, ku janë realizuar 4,437 aplikime intravitreale dhe intrakamerale (Anti-VEGF etj.), 296 procedura YAG-laser, 344 vitrektomi (PPV), 79 procedura Cross-Linking, 78 ndërhyrje Ex-Silicon dhe 344 tomografi korneale, çka tregon për një orientim të fuqishëm drejt trajtimeve moderne dhe teknologjikisht të avancuara.

Në fushën ambulatorë dhe diagnostike, gjatë vitit janë realizuar gjithsej 46,943 vizita ambulatorë dhe konsultative, 6,291 ekzaminime OCT, 784 ECHO okulare, 945 ekzaminime ROP, 689 ekzaminime të fushës vizive (perimetri) dhe 1,171 shërbime laboratorike, duke dëshmuar një fluks shumë të madh pacientësh dhe rol të rëndësishëm të klinikës edhe në diagnostikë të specializuar.

Klinika e Kardiokirurgjisë:

Numri i Procedurave Kirurgjike: Janë kryer gjithsej 414 operacione gjatë kësaj periudhe, me operacione komplekse përfshirë bypass-e të ndryshme dhe ndërhyrje të valvulave të zemrës.

Lloji i ndërhyrjes	Totali
CABG gjithsej (x1–x4 + kombinime)	265+
CABG x3	162
CABG x4	52
AVR – mekanik	23
AVR – biologjik	8
MVR – mekanik	22
AVR + MVR	7
Procedura të aortës (Bentall, Hemiarch, Total arch, etj.)	~25+
Reoperime (Redo CABG / Valves / Aorta)	>17
VSD / ASD / Myxoma / procedura kongjenitale	>20

Gjatë vitit 2025, Klinika e Kardiokirurgjisë ka zhvilluar një aktivitet intensiv dhe të qëndrueshëm klinik, duke funksionuar me kapacitet të plotë me 17 shtretër dhe duke trajtuar gjithsej 505 pacientë të shtrirë, me 5,986 ditë shërimi të realizuara. Gjatesia mesatare e qëndrimit spitalor ishte rreth 11.9 ditë, që reflekton kompleksitetin e rasteve të trajtuara.

Gjatë vitit janë realizuar gjithsej 414 ndërhyrje kirurgjikale madhore kardiake, ku dominojnë ndërhyrjet e revaskularizimit koronar (CABG), veçanërisht CABG x3 (162 raste) dhe CABG x4 (52 raste), si dhe një numër i konsiderueshëm ndërhyrjesh valvulare (AVR, MVR dhe kombinime). Po ashtu, klinika ka realizuar një volum të rëndësishëm ndërhyrjesh komplekse në aortë (Bentall, hemiarch, total arch, diseksione akute), si dhe reoperime kardiake, çka dëshmon nivel të lartë profesional dhe referencë terciare.

Në aspektin diagnostik, janë realizuar 9,675 ekzaminime (EKG, ECHO, RTG, laborator), që mbështesin drejtpërdrejt aktivitetin kirurgjikal dhe ndjekjen post-operative të pacientëve.



Aktiviteti ambulator dhe konsultativ ka qenë gjithashtu i qëndrueshëm me mbi 1,400 vizita, ndërsa janë lëshuar 504 pacientë pas trajtimit të plotë spitalor. Gjatë vitit, lista e pritjes ka qenë mesatarisht rreth 100 pacientë, duke reflektuar kërkesë të lartë për shërbime kardiokirurgjike në nivel vendi.

Numri i vdekjeve ishte 21 raste, në kontekst të një profili pacientësh me rrezik të lartë dhe patologji të avancuara kardiovaskulare, çka e bën këtë indikator klinikisht të arsyeshëm për kompleksitetin e rasteve të trajtuara.

Klinika e Kirurgjisë Abdominale:

Indikatorët Kryesorë të Punës

Fusha	Indikatori	Totali 2025
Kapaciteti spitalor	Numri i shtretërve (mesatar vjetor)	66
	Pacientë të shtrirë	3,084
	Ditë shërimi	17,657
	Shfrytëzimi i kapaciteteve	74.4%
Aktiviteti kirurgjikal	Operacione / shërbime gjithsej	2,578
	Intervenime emergjente	1,199
	Intervenime elektive	1,379
	Appendicitis acuta	406
	Cholecystitis calculosa	355
	Hernia inguinalis	239
	ERCP	282
	Hernie (të gjitha llojet)	~430+
Vizita & urgjenca	Vizita emergjente	7,691
	Vizita ambulantore	5,764
Procedura & shërbime ditore	Pastrim plage	1,044
	Heqje e pejve	700
	Incizione	150
	Operacione lokale	100
Diagnostikë	Shërbime diagnostike (EHO)	2,589
	EKG	2,892
	Gastroskopi	72
	Kolonoskopi	84
	Rectoskopi	31
	Biopsi	76
	Polipectomi	10
	Stentim/dilatim ezofagu	16

Gjatë vitit 2025, shërbimi ka funksionuar me një kapacitet prej 66 shtretërve dhe ka trajtuar gjithsej 3,084 pacientë të shtrirë, duke realizuar 17,657 ditë shërimi dhe një shfrytëzim mesatar të kapaciteteve prej 74.4%.



Gjatë vitit janë realizuar gjithsej 2,578 operacione dhe shërbime kirurgjikale, nga të cilat 1,199 kanë qenë intervenime emergjente dhe 1,379 intervenime elektive, çka dëshmon ngarkesë të lartë urgjente dhe rol kyç të shërbimit në menaxhimin e rasteve akute kirurgjikale.

Dominon patologjia abdominale akute, me 406 raste të apendicitit akut, 355 kolecistite kalkuloze dhe 239 hernie inguinale, si dhe një volum shumë të konsiderueshëm procedurash endoskopike dhe intervenuese si ERCP (282 procedura).

Aktiviteti ambulator dhe emergjent ka qenë shumë intensiv, me 7,691 vizita emergjente dhe 5,764 vizita ambulantore. Paralelisht janë realizuar mijëra procedura ditore si pastrime plagësh (1,044), heqje pejsh (700) dhe incizione (150).

Në aspektin diagnostik janë kryer mbi 2,500 ekzaminime EHO, gati 2,900 EKG, si dhe dhjetëra procedura endoskopike (gastroskopi, kolonoskopi, biopsi, stentime).



KLINIKA OBSTETRIKE GJINEKOLOGJIKE (KOGJ) FUSHA	INDIKATORI	TOTALI 2025
 KAPACITETI SPITALOR	Shtretër në shfrytëzim	280
	Pacientë të shtrirë	27,606
	Ditë shërimi	65,739
	Shfrytëzimi i kapaciteteve	64.5%
	Numri i vdekjeve (onkologji-operative)	3
 AKTIVITETI KIRURGJIKAL	Operacione / shërbime gjithsej	4,024
 LINDJET	Totali i lindjeve	7,458
	Lindje me prerje cezariane (S/C)	3,074
	Totali i foshnjeve të lindura	7,544
	Lindje gemellare	208
 VIZITA & SHËRBIME	Vizita ambulantore	5,448
	Egzaminime gjithsej	63,512
	Konsulta IVF	1,277
	Konsulta nga klinikat tjera	2,364
	Konsultime në ambulantën e pranimit	1,575
 DIAGNOSTIKË	Analiza laboratorike	26,211
	CTG	61,397
	EKG	2,369
	Pap Teste	3,290
	Kolposkopi	991
	Marrje strishove	4,868
 PROCEDURA & SHËRBIME DITORE	Përpunim plage / heqje penjesh	12,249
	Intervenime tjera konservative	2,536
	EMLD sutura	1,596
	Ruptura perineale + sutura	858
 RIPRODHIMI I ASISTUAR (IVF/IUI)	Rikonsulta IVF	306
	HSG	54
	Spermogram	56
	Inseminime (IUI)	6
	Stimulime IVF	7

Gjatë vitit 2025, shërbimi ka funksionuar me një kapacitet prej 280 shtretërve dhe ka trajtuar gjithsej 27,606 pacientë të shtrirë, duke realizuar 65,739 ditë shërimi dhe një shfrytëzim mesatar

të kapaciteteve prej 64.5%. Profili i mortalitetit mbetet shumë i ulët, me vetëm 3 raste vdekjeje në kuadër të onkologjisë operative.

Gjatë vitit janë realizuar gjithsej 4,024 operacione dhe shërbime, duke reflektuar një ngarkesë të lartë kirurgjikale dhe procedurale. Aktiviteti obstetrik ka qenë shumë intensiv me 7,458 lindje, prej të cilave 3,074 ose rreth 41% janë kryer me prerje cezariene, ndërsa janë lindur gjithsej 7,544 foshnje, përfshirë 208 lindje gemellare.

Aktiviteti diagnostik dhe ambulator ka qenë shumë i gjerë, me mbi 63 mijë ekzaminime, 61 mijë CTG, mbi 26 mijë analiza laboratorike, rreth 5,400 vizita ambulantore dhe mijëra shërbime shtesë si marrje strishove, Pap teste dhe kolposkopi.

Shërbimet procedurale ditore kanë qenë jashtëzakonisht intensive, me mbi 12,000 përpunime plagësh dhe heqje penjesh, si dhe mijëra intervenime konservative dhe sutura.

Në fushën e fertilitetit dhe riprodhimit të asistuar është shënuar një aktivitet në rritje, me mbi 1,200 konsulta IVF dhe dhjetëra procedura specifike (HSG, spermogram, inseminime, stimulime).

Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve

FUSHA	INDIKATORI	TOTALI 2025
 KAPACITETI SPITALOR	Numri i shtretërve	20
	Pacientë të shtrirë	1,683
	Ditë shërimi	4,417
	Shfrytëzimi i kapaciteteve (mesatar)	60.5%
 AKTIVITETI KIRURGJIKAL	Operacione/Shërbime gjithsej	1,293
	Intervenime emergjente	518
	Intervenime elektive	775
 LLOJET KRYESORE TË OPERACIONEVE	Appendicitis ac	392
	Retentio testis	230
	Hernia inguinalis	199
	Hydronephrosis	43
	Hypospadia	71
	Invaginatio	10
	Scrotum ac	19
	Ileus	33
 SHËRBIME EMERGJENTE & AMBULATORE	Vizita emergjente	6,225
	Vizita ambulantore	3,111
 DIAGNOSTIKË	Shërbime diagnostike (EHO/RTG/EKG)	1,675

Gjatë vitit 2025, Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve në QKUK ka zhvilluar aktivitet të lartë klinik dhe kirurgjikal, duke operuar me një kapacitet prej 20 shtretërve dhe duke trajtuar gjithsej 1,683 pacientë të shtrirë. Gjatë vitit janë realizuar 4,417 ditë shërimi, me një shfrytëzim mesatar të kapaciteteve prej 60.5%, që dëshmon një ngarkesë të qëndrueshme dhe të balancuar të repartit gjatë gjithë vitit.

Në aspektin kirurgjikal, janë realizuar gjithsej 1,293 operacione dhe shërbime, nga të cilat 518 kanë qenë intervenime emergjente dhe 775 intervenime elektive, duke reflektuar një profil të kombinuar urgjent dhe të planifikuar të veprimtarisë së klinikës. Patologjitë më të shpeshta të trajtuara kirurgjikalisht kanë qenë apendiciti akut (392 raste), retentio testis (230 raste) dhe hernia inguinale (199 raste), të cilat përbëjnë pjesën dërrmuese të volumit operativ.

Aktiviteti ambulator dhe emergjent ka qenë gjithashtu shumë intensiv, me gjithsej 6,225 vizita emergjente dhe 3,111 vizita ambulantore, duke konfirmuar rolin kyç të Klinikës së Kirurgjisë së Fëmijëve si qendër referente për menaxhimin e rasteve kirurgjikale pediatrike në nivel vendi. Në të njëjtën kohë, janë realizuar 1,675 shërbime diagnostike (EHO, RTG, EKG), të cilat kanë mbështetur drejtpërdrejt procesin diagnostik dhe vendimmarrjen klinike.

Klinika e Urologjisë:

FUSHA	INDIKATORI	TOTALI 2025
KAPACITETI SPITALOR	Numri i shtretërve	30
	Pacientë të shtrirë	1,560
	Ditë shërimi	5,260
	Gjatësia mesatare e shërimit (ALOS)	3.37 ditë
	Shfrytëzimi i kapaciteteve (BOR)	65.22%
	Numri i vdekjeve	7
AKTIVITETI INTERVENUES	Procedura intervenuese gjithsej	3,706
	Intervenime emergjente	30
	Intervenime elektive (gjithsej)	1,084
	Operacione të hapura/laparoskopike (Salla 1)	389
	Endourologji (Salla 2)	695
	Uretrocistoscopi intervente (stent)	665
	Biopsi të prostatës	263
	ESËL	1,242
	Nefrostoma	415
	Uretrocistoscopi diagnostike	1,526
DIAGNOSTIKË	Ekzaminime urodinamike	214
AKTIVITETI AMBULATOR	Vizita ambulantore	8,216

Gjatë vitit 2025, Klinika e Urologjisë në QKUK ka funksionuar me një kapacitet prej 30 shtretërve dhe ka trajtuar gjithsej 1,560 pacientë të shtrirë, duke realizuar 5,260 ditë shërimi dhe një



shfrytëzim mesatar të kapaciteteve prej 65.22%. Gjatësia mesatare e qëndrimit spitalor ka qenë 3.37 ditë, që dëshmon për efikasitet relativisht të mirë në menaxhimin e rasteve spitalore.

Në aspektin intervenues, janë realizuar gjithsej 3,706 procedura urologjike, ku dominojnë procedurat minimalisht invazive dhe endourologjike. Veçohen 1,242 procedura ESËL, 695 ndërhyrje endourologjike, 665 uretrocistoscopi intervente për stentim, si dhe 415 nefrostoma, që dëshmojnë për profil të avancuar tekniko-intervenues të klinikës.

Gjatë vitit janë kryer edhe 1,526 uretrocistoscopi diagnostike dhe 214 ekzaminime urodinamike, ndërsa aktiviteti ambulator ka qenë shumë intensiv me 8,216 vizita ambulantore.

2.3. Shërbimet shëndetësore të ofuara nga Klinikat Internistike në QKUK

Njësitë e QKUK	Shfr i kapaciteteve	Sherimi
Klinika e Dermatovenerologjisë	69%	6.1
Klinika e Gastroenterologjisë	83%	8.4
Klinika e Hematologjisë	57%	6.2
Klinika e Neonotologjisë	60%	3.7
Klinika Infektive	72%	10.3
Klinika e Nefrologjisë	100%	7.3
Klinika e Pulmologjisë	89%	12.4
Klinika e Kardiologjisë	97%	3.5
Klinika e Pediatriisë	79%	5.5
Klinika e Endrokrinologjisë	56%	8.5
Klinika e Neurologjisë	83%	7.2
Klinika e Mjekesisë Fizikale dhe Rehabilitim	64%	16.4
Klinika e Onkologjisë	63%	9.4
Klinika e Psikiatriisë	58%	21.3
Klinika e Reumatologjisë	86%	6.9
Klinika e Alergologjisë me Imunologji	64%	3.9
Instiuti i Psikiatriisë Forenzike	90%	23.9

Duke analizuar tabelën e të dhënave, identifikohen disa pika kyçe për efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara në këto klinika.

Shfrytëzimi i Kapaciteteve:

- Shumica e klinikave kanë një shfrytëzim të lartë të kapaciteteve. Klinika e Nefrologjisë ka një shfrytëzim mbi kapacitetin, në 100%, gjë që tregon mbingarkesë të kapacitetit të saj.
- Klinikat si ajo e Psikiatriisë ka shfrytëzim më të ulët me 58%.

Mesatarja e Ditëve të Shërimit:

- Klinika e Psikiatrisë dhe Instituti i Psikiatrisë Forenzike kanë mesataren më të lartë të ditëve të shërimit, përkatësisht 21.3 dhe 23.9 ditë. Kjo është normale për trajtime psikiatrike që kërkojnë kohë më të gjatë rehabilitimi.
- Klinika e Neonatologjisë dhe ajo e Kardiologjisë kanë një kohëzgjatje mesatare të shërimit prej 3.7 ditësh dhe 3.5 ditësh shërimi për pacient.

Vizitat Ambulatorike dhe Diagnostike:

- Klinika e Pediatriës ka gjithsej 65,463 vizita ambulantore dhe specialitke, dhe ajo e Kardiologjisë janë ndër klinikat më të ngarkuara me vizita ambulatorike dhe specialistike 22110 duke treguar një kërkesë të lartë për shërbime ambulantore dhe specialistike
- Klinika e Dermatovenerologjisë ka ofruar 24,522 vizita ambulantore dhe specialistike.

Klinika e Kardiologjisë

FUSHA	INDIKATORI KRYESOR	TOTALI
QARKULLIMI I PACIENTËVE	Pacientë të pranuar	7,445
	Pacientë të liruar	7,435
	Ditë qëndrimi (ditë mjekimi)	26,423
AMBULANTA & KONSULTA	Vizita ambulatorie specialistike	17,079
	EKG ambulantore	17,169
	Konsulta	5,031
DIAGNOSTIKË JO-INVAZIVE	Echokardiografi	7,288
	Echo trans-ezofageale	386
	Ergometri (Stress Test)	1,832
	Holter EKG	996
	Holter HTA	32
	CT Angio koronare	285
	Koronarografi	3,843
ANGIOGRAFI & INTERVENIME	Stent procedura	2,658
	Stentë të vendosur	3,805
	ASD	7
ELEKTROSTIMULIM & EP	PFO	5
	Pacemaker i përhershëm	138
	ICD	50
	CRT-D	41
	PC i përkohshëm	26
	Ripozicionim elektrode	13
	Testime PM & ICD	1,402
	Ablacione (Elektrofiziologji)	35
SHËRBIME MBËSHTETËSE	Pastrim plagësh	302
	Heqje pejsh	326
	Komisione ES & EF	315



Gjatë vitit 2025, Klinika e Kardiologjisë në kuadër të SHSKUK ka zhvilluar një aktivitet shumë të lartë klinik, diagnostik dhe intervenues, duke trajtuar gjithsej 7,445 pacientë të shtrirë dhe duke realizuar 26,423 ditë mjekimi. Numri i pacientëve të liruar ishte 7,435.

Aktiviteti ambulator ka qenë jashtëzakonisht intensiv, me mbi 17,000 vizita specialistike, 17,169 EKG dhe mbi 5,000 konsulta, duke dëshmuar një ngarkesë shumë të lartë në shërbimet ambulatore dhe diagnostike.

Në fushën e diagnostikës jo-invazive janë realizuar mbi 7,200 ekokardiografi, 1,832 teste të ngarkesës (ergometri), gati 1,000 Holter EKG dhe 285 CT angiografi koronare, çka dëshmon kapacitet të avancuar diagnostik.

Në aspektin invaziv, klinika ka realizuar 3,843 koronarografi dhe 2,658 procedura stentimi, me gjithsej 3,805 stentë të vendosur, duke e konfirmuar rolin e saj si qendër referente kombëtare për kardiologji intervenuese.

Shërbimet e elektrostimulimit kanë shënuar gjithashtu volum të konsiderueshëm, me 138 pacemaker të përhershëm, 50 ICD, 41 CRT-D dhe mbi 1,400 testime të pajisjeve kardiake, si dhe 35 procedura të elektrofiziologjisë (ablacione).

Klinika e Neurologjisë

FUSHA	INDIKATORI	TOTALI 2025
 KAPACITETET	Numri i shtretërve	49
 HOSPITALIZIME	Pacientë të shtrirë	2,072
 QËNDRIMI	Ditë shërimi	14,826
 MESATARJA	Gjatësia mesatare e qëndrimit	7.7 ditë
 SHFRYTËZIMI	Shfrytëzimi i kapaciteteve	82.9%
 MORTALITETI	Numri i vdekjeve	239
 VIZITA	Vizita ambulantore	11,863
 DIAGNOSTIKË	EEG	4,168
	EMNG	2,479
	Doppler UZ	2,753
 SËMUNDJE DEMIELINIZUESE	Vizita në kabinet	3,762
 NEUROPSIKOLOGJI	Konsulta	312
 NEUROFIZIATRI	Pacientë	469
 NEUROFIZIATRI	Seanca terapeutike	2,345
 PATOLOGJITË KRYESORE	Epilepsi	2,463
	Marramendje / jostabilitet	2,267
	Kokedhimbje	2,230
	Insult cerebral (I63)	649
	Skleroza multiple	451
	Hipertension arterial	1,109
	Spondilozë	594
	Migrenë	293
	Hemorragji intracerebrale	61

Gjatë vitit 2025, Klinika e Neurologjisë ka realizuar një volum shumë të lartë të aktivitetit klinik dhe diagnostik, duke trajtuar gjithsej 2,072 pacientë të shtrirë dhe duke gjeneruar 14,826 ditë shërimi, me një gjatësi mesatare qëndrimi prej 7.7 ditësh dhe një shfrytëzim të kapaciteteve prej 82.9%, çka tregon ngarkesë të lartë dhe përdorim intensiv të kapaciteteve spitalore.

Në aspektin ambulator, janë realizuar 11,863 vizita, duke dëshmuar një fluks shumë të madh të pacientëve neurologjikë edhe jashtë trajtimit spitalor.

Aktiviteti diagnostik ka qenë shumë i zhvilluar, me 4,168 EEG, 2,479 EMNG dhe 2,753 ekzaminime Doppler, ndërsa kabineti i sëmundjeve demielinizuese ka regjistruar 3,762 vizita, duke reflektuar rritje të rasteve kronike neurologjike.



Sëmundjet dominante të trajtuara gjatë vitit kanë qenë epilepsia (2,463 raste), marramendja dhe çrregullimet e ekuilibrit (2,267), kokedhimbjët (2,230), si dhe sëmundjet cerebrovaskulare, përfshirë insultin cerebral (649 raste) dhe hemorragjinë intracerebrale (61 raste).

Në fushën e rehabilitimit dhe rikuperimit funksional, Neurofiziatra ka realizuar 2,345 seanca terapeutike për 469 pacientë, duke luajtur rol të rëndësishëm në rehabilitimin neurologjik.

Numri i vdekjeve (239 raste) reflekton profilin e rëndë klinik të pacientëve të trajtuar në këtë klinikë, veçanërisht rastet me insult akut, hemorragji cerebrale dhe patologji të rënda neurodegenerative.

Klinika e Pediatriisë

Përmbledhje Ekzekutive e Punes së Realizuar me Indikatorë Kyç të Performances



FUSHA	INDIKATORI	TOTALI VJETOR
 KAPACITETET	Numri i shtretërve	151
 HOSPITALIZIME	Ditët e mjekimit	43,725
 SHFRYTËZIMI	Shfrytëzimi i kapaciteteve	79.17%
 URGJENCA	Vizita në Emergjencën Pediatrike	44,698
 AMBULANTA	Vizita ambulantore specialistike	20,765
 SPITALI	Pranime	7,937
	Lëshime	7,948
 MORTALITETI	Exitus	27
 KARDIOLOGJI	EKG	1,375
 NEURO	EEG	1,159
	Holter	153
	Ergometri	30
 ECHO	Echo e zemrës	2,517
	Echo abdomeni	2,288
	Echo truri	677
	Echo mushkërive	749
	Echo tiroide	40
	Echo TEE	9
	Echo fetale	21
	Echo karotide	7
	Echo syri	11
 PROCEDURA	Dializa	14
	Spirometria	121
	Hemodilimi	2
 METABOLIKE	Klori në djersë	97
 GJENETIKË	Këshillime gjenetike	54
 DIABET	Edukim për fëmijë me diabet	762
 LABORATOR	Marrje materiale biologjike	519
	Strisho periferike	2,436
	Floë-citometri	31
	Gazra në gjak (ABG/SAB)	7,356
 INVAZIVE	Punksion lumbal	116
	Punksion oseal	61
	Punksion torakal	3
	Torakocentezë	6
 INTENSIVË	Vendosje SNG	736
	Lavazh gastrik	312
	Intubime	95
	Ndërrim trakeostomie	14
 MIKROBIOLOGJI	Kulturë aspiratesh	1,261
 KATETERË	Urinar	183
	Qendror	117
 HEMATO-ONKO	Biopsi palce	7
	Plazmaferezë	38
 PROCEDURA	Qepje kateteri	23



	Pastrim plage	71
⚡ PAJISJE	ICD	1
🔧 PROCEDURA	Videolaringoskopi	1
🔬 ENDOSKOPI	Gastroskopi	1

Gjatë vitit 2025, Klinika e Pediatrikë në QKUK ka zhvilluar një aktivitet shumë të lartë klinik, diagnostik dhe urgjent, duke funksionuar si qendra kryesore terciare pediatrike për gjithë vendin.

Me një kapacitet prej 151 shtretërve, janë realizuar gjithsej 43,725 ditë mjekimi, me një shkallë shfrytëzimi të kapaciteteve prej 79.17%, që dëshmon për ngarkesë të vazhdueshme dhe përdorim intensiv të resurseve spitalore.

Në Emergjencën Pediatrike janë trajtuar 44,698 raste, ndërsa në ambulanta specialistike janë kryer 20,765 vizita, duke e bërë Klinikën një nga njësitë me fluksin më të madh të pacientëve në QKUK.

Në aspektin spitalor janë realizuar 7,937 pranime dhe 7,948 lëshime, me vetëm 27 raste exitusi, çka tregon për menaxhim profesional të rasteve të rënda pediatrike.

Aktiviteti diagnostik ka qenë jashtëzakonisht intensiv, veçanërisht në:

- Ekzaminimet ECHO (mbi 6,300 gjithsej),
- Analizat e gazrave në gjak (7,356),
- Strishot periferike (2,436),
- EEG (1,159) dhe EKG (1,375).

Një vëllim i konsiderueshëm është realizuar edhe në procedurat invazive dhe të kujdesit intensiv: 736 vendosje sondash nazogastrike, 312 lavazhe gastrike, 95 intubime dhe 38 plazmafereza.

Gjithashtu, Klinika ka luajtur rol kyç në:

- Menaxhimin e sëmundjeve kronike (762 edukime për diabet),
- Diagnostikën gjenetike dhe metabolike,
- Trajtimin e rasteve komplekse hematologjike dhe nefrologjike pediatrike.



Klinika e Gastroenterologjisë dhe Hepatologjisë:

FUSHA	INDIKATORI	TOTALI VJETOR
KAPACITETET	Numri i shtretërve	33
SPITALI	Pacientë të shtrirë	1,284 (sipas shifrave mujore)
HOSPITALIZIME	Ditë shërimi	10,332
ALOS	Gjatësia mesatare e qëndrimit	8.4 ditë
BOR	Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve	73.6%
MORTALITETI	Nr. i vdekjeve	66
LISTA E PRITJES	Kohë pritjeje	1.5 – 2 muaj

PROCEDURA	TOTALI
GASTROSKOPI – GJITHSEJ	2,222
└ DIAGNOSTIKE	1,003
└ INTERVENTE	1,219
KOLONOSKOPI – GJITHSEJ	1,500
└ DIAGNOSTIKE	833
└ INTERVENTE	667
EUS	53
KAPSULË ENDOSKOPIKE	7

Brenda procedurave intervente:

- Hemostaza endoskopike: **≈ 227**
- Polipektomi (lukth + kolon): **≈ 63**
- Vendosje klipsash / endoloop: **≈ 72**
- Ligatura varikse / hemorroide: **≈ 40**
- Largim trupa të huaj: **≈ 74**
- Dilatime ezofagu: **≈ 32**

Gjatë vitit 2025, Klinika ka funksionuar me kapacitet prej 33 shtretërsh dhe ka realizuar mbi 10,300 ditë shërimi, me një shfrytëzim mesatar të kapaciteteve rreth 74%, çka tregon për ngarkesë të qëndrueshme spitalore gjatë gjithë vitit.

Aktiviteti kryesor i Klinikës mbetet endoskopia digjестive, me gjithsej:

- 2,222 gastroskopi dhe
- 1,500 kolonoskopi,



ku mbi 50% e tyre janë procedura intervente terapeutike (hemostaza, polipektomi, ligatura, klipsa, heqje trupash të huaj, etj.), gjë që dëshmon për profil të avancuar terciar dhe trajtim të rasteve komplekse.

Paralelisht, Klinika ka përballuar:


- mbi 8,000 vizita ambulantore,
- rreth 2,800 vizita emergjente/konsultative,
- mbi 2,600 transfuzione gjaku dhe mbi 800 terapi biologjike, duke u shndërruar në qendër reference për patologjitë gastroenterologjike dhe hepatologjike.

Gjatësia mesatare e qëndrimit spitalor prej rreth 8.4 ditësh reflekton kompleksitetin e rasteve të trajtuara, ndërsa ekzistenca e listës së pritjes 1.5–2 muaj tregon kërkesë të lartë për shërbimet endoskopike.

Në aspektin e sigurisë dhe rezultateve klinike, janë regjistruar gjithsej 66 vdekje gjatë vitit, kryesisht të lidhura me patologji të rënda dhe komplikime serioze.

2.4. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Klinkat/shërbimet diagnostike në QKUK

Klinika e Radiologjisë:



Gjatë vitit raportues, aktiviteti diagnostik radiologjik ka shënuar volum shumë të lartë shërbimesh, duke reflektuar rolin kyç të radiologjisë në mbështetjen e proceseve diagnostike dhe terapeutike në të gjithë SHSKUK.


Nga të dhënat e paraqitura, vërehet se Radiografia (RTG) dominon dukshëm strukturën e shërbimeve me gjithsej 85,602 ekzaminime, duke përbërë shtyllën kryesore të diagnostikës imazherike për shkak të qasjes së shpejtë, kostos më të ulët dhe përdorimit të gjerë klinik.

Pas RTG-së, Tomografia e Kompjuterizuar (CT) zë vendin e dytë me 30,694 ekzaminime, ndërsa Ultrazëri me 27,956 ekzaminime mbetet një nga metodat më të përdorura jo-invazive, veçanërisht për diagnostikë fillestare dhe ndjekje klinike.

Rezonanca Magnetike (MRI) ka realizuar 16,938 ekzaminime, duke dëshmuar rritje të vazhdueshme të kërkesës për diagnostikë të avancuar dhe precize, veçanërisht në neurologji, ortopedi dhe onkologji.

Procedurat më të specializuara dhe invazive, si Fluoroscopia (875 raste), Angio CT (377), DSA (75) si dhe biopsitë e drejtuara me imazheri (me UZ: 889, me CT: 255 dhe biopsi e gjirit: 301), përbëjnë një volum më të vogël, por me rëndësi të lartë klinike, duke reflektuar rritjen e kapaciteteve intervenuese dhe diagnostikës së targetuar.

Mjekësia Nukleare:




Gjatë vitit 2025, në Shërbimin e Mjekësisë Nukleare është realizuar një volum i lartë i ekzaminimeve diagnostike, ku dominon DEXA (4,843 raste) dhe Sintigrafia e kockave (2,176 raste), që dëshmojnë për kërkesë të shtuar për vlerësimin e patologjive skeletore dhe densitetit kockor. Gjithashtu, është evidentuar një aktivitet i qëndrueshëm në ekzaminimet PET/CT (654 raste) dhe Echo (729 raste).

Spektri i shërbimeve përfshin ekzaminime të specializuara të organeve: sintigrafi të kockave, veshkave, tiroides, paratiroides, zemrës, mushkërive, gastrointestinale dhe limfoscintigrafi, të cilat sigurojnë mbështetje të rëndësishme për diagnostikimin, stadifikimin dhe ndjekjen e sëmundjeve të ndryshme. Këto të dhëna konfirmojnë rolin strategjik të Shërbimit të Mjekësisë Nukleare në procesin diagnostik të QKUK/SHSKUK dhe nevojën për ruajtjen dhe avancimin e kapaciteteve teknologjike dhe profesionale të këtij shërbimi.



Shërbimi i Mikrobiologjisë Klinike dhe Klinikën e Biokimisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës



Gjatë vitit raportues, Shërbimi i Mikrobiologjisë ka zhvilluar një aktivitet të lartë diagnostik, duke realizuar gjithsej 27,213 kultura mikrobiologjike, 10,441 analiza serologjike si dhe 562 ekzaminime sanitare. Vëllimi i madh i kulturave dëshmon për rolin kyç të këtij shërbimi në diagnostikimin e infeksioneve, përcaktimin e terapisë adekuate antimikrobike dhe monitorimin e infeksioneve spitalore. Analizat serologjike kanë pasur një peshë të rëndësishme në diagnostikimin e sëmundjeve infektive dhe imunologjike, ndërsa kontrollet sanitare kanë kontribuar në garantimin e sigurisë dhe standardeve higjieno-sanitare në institucion. Këto të dhëna konfirmojnë rëndësinë strategjike të Shërbimit të Mikrobiologjisë në funksionimin e sistemit shëndetësor dhe në mbështetjen e vendimmarrjes klinike.



Klinika e Biokimisë



Gjatë vitit raportues, Shërbimi i Labororit Klinik ka realizuar një volum jashtëzakonisht të lartë të punës, me gjithsej 1,988,538 analiza laboratorike të kryera për 430,622 pacientë, duke dëshmuar rolin kyç të laboratorit në funksionimin e të gjithë sistemit spitalor.

Struktura e analizave tregon një dominim të qartë të:

- Analizave biokimike dhe metabolike (Glukoza 127,449, Urea 129,031, Kreatinina 128,255, CRP 112,509, AST/ALT mbi 113,000 secila),
- Hematologjisë (Hemogram 191,669, Sedimenti i urinës 31,149, Leukocyte 5,687),
- Kardiologjisë emergjente (Troponina 19,701, D-Dimer 10,324),
- Analizave gazore (mbi 62,000 analiza ABG/SAB),
- Hormonologjisë dhe imunologjisë (TSH, FT3, FT4, PTH, Vitamina D, AFP, PSA, etj.),
- Markerëve tumoralë (CA 125, CA 19-9, CEA, HE4, CYFRA 21-1, etj.).

Numri shumë i lartë i CRP, Prokalcitoninës, Troponinës dhe analizave gazore dëshmon rolin kritik të laboratorit në menaxhimin e rasteve urgjente, infektive dhe intensive.

Po ashtu, prania e një game shumë të gjerë analizash të specializuara (autoimune, onkologjike, hormonale, toksikologjike, likvor, biopsi, strisho, punkcione, etj.) tregon se laboratori ka funksionuar si shtyllë qendrore diagnostike për të gjitha klinikat e QKUK-së.



Instituti i Patologjisë:

Pikat Kryesore

NR	LLOJI I SHËRBIMIT	GJITHSEJ 2025
1	Biopsi	14,735
2	Citologji	2,520
3	Pap test screening	1,798
4	Pap test KOGJ	3,447
5	Biopsi intraoperative	58
6	Histokimi	75
7	Imunohistokimi	1,642
8	SISH	30
9	Autopsi	7
10	Testime molekulare	306
11	Konsulta nga jashtë	872

Gjatë vitit 2025, Instituti i Anatomisë Patologjike ka realizuar një volum shumë të lartë dhe të qëndrueshëm shërbimesh diagnostike, duke dëshmuar rol kyç në mbështetjen e diagnostikimit klinik në nivel vendi. Në total janë kryer **14,735 biopsi**, **2,520 citologji**, **1,798 Pap-teste screening**, si dhe **3,447 Pap-teste KOGJ**, që dëshmon një ngarkesë të lartë pune në fushën e diagnostikës onkologjike dhe skringut.

Një kontribut i veçantë është dhënë edhe në **imunohistokimi (1,642 raste)** dhe **histokimi (75 raste)**, që reflekton rritjen e kompleksitetit të rasteve dhe nevojën për diagnostikë të avancuar. Gjithashtu janë realizuar **306 testime molekulare**, duke treguar zhvillim të vazhdueshëm të kapaciteteve moderne diagnostike.



Klinika e Onkologjisë:



Klinika e Onkologjisë

2,082

Rastet e reja




Gjatë periudhës së raportuar, struktura e rasteve të reja onkologjike tregon se barra më e madhe e sëmundshmërisë mbetet e përqendruar në tre grupe kryesore: kanceri i gjirit (459 raste), tumoret gastrointestinale (430 raste) dhe kanceret urogjenitale të meshkujt (336 raste) dhe të femrat (310 raste). Këto katër kategori përbëjnë pjesën dërrmuese të rasteve të reja të diagnostikuara dhe dëshmojnë për nevojën e fokusimit të kapaciteteve diagnostike dhe terapeutike pikërisht në këto fusha.

Në anën tjetër, kanceri i mushkërive (283 raste) mbetet një barrë e konsiderueshme klinike, ndërsa rastet e kokës dhe qafës dhe indeve të buta/lëkurës paraqesin volum më të ulët, por kërkojnë trajtim të specializuar dhe multidisiplinar.

3. Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës (QKSUK)

Gjatë vitit raportues, Ne QKSUK është zhvilluar një aktivitet intensiv dhe të qëndrueshëm shërbimesh shëndetësore, duke ofruar kujdes gjithëpërfshirës stomatologjik për një numër shumë të madh pacientësh dhe duke mbuluar pothuajse të gjitha fushat kryesore të stomatologjisë moderne.



Në total, gjatë vitit janë realizuar 273,407 shërbime stomatologjike dhe janë trajtuar 71,887 pacientë, gjë që dëshmon për një ngarkesë të lartë pune dhe rol thelbësor të këtij shërbimi në sistemin shëndetësor publik.

Nga analiza sipas klinikave, numrin me te madhe të aktivitetit e mbajnë Klinika e Ortodoncisë (48,371 shërbime), Klinika e Sëmundjeve të Dhëmbit (48,064), Klinika e Protetikës Stomatologjike (48,021) dhe Klinika e Kirurgjisë Orale (45,423), të cilat së bashku përbëjnë pjesën më të madhe të volumit total të punës. Kjo tregon një kërkesë të lartë dhe të vazhdueshme për trajtime restauruese, protetike, ortodontike dhe kirurgjikale.

Në aspektin e llojit të shërbimeve, dominojnë mbushjet kompozite (11,902 raste), nxjerrjet e dhëmbëve (9,019) dhe largimi i depozitimeve të forta (6,194), çka tregon se një pjesë e madhe e punës është e orientuar drejt trajtimeve bazike terapeutike dhe ndërhyrjeve për menaxhimin e patologjive të avancuara dentare dhe periodontale.



Po ashtu, aktiviteti diagnostik radiologjik është shumë i theksuar, me gjithsej 18,794 ekzaminime, ku mbizotërojnë ortopantomografitë (15,516), të ndjekura nga RTG retroalveolare (2,633) dhe 3D/Telerentgen (645). Kjo dëshmon për rëndësinë e madhe të mbështetjes diagnostike imazherike në planifikimin dhe realizimin e trajtimeve.

Klinika	Klinika e Pedodoncisë	Klinika e Kirurgjisë Orale	Klinika e Ortodoncisë	Klinika e Parodontologjisë dhe Mjekësisë Orale	Klinika e Protetikës Stomatologjike	Klinika e Sëmundjeve të Dhëmbit me Endodoncion	Klinika e Triazhimit	Nr total i shërbimeve
Nr i pacientëve	11690	10436	12227	5154	13288	10149	8943	71887
Shërbimet								0
Nr i vizitave	11690	10436	12227	5154	13288	10149	8943	71887
Ortopantomografi me analize	900	5813	3627	341	1371	22	3442	15516
RTG Retroalveolare me analize	184	243	7	36	210	922	1031	2633
3D dhe Telerentgen me analize	4	418	179	6	27	6	5	645
Aparate ortodontike mobile			1007					1007
Aparate ortodontike fikse			299					299
Zgjerues rapid i nofullës			38					38
Implante dentare		96						96
Proteza mobile akrilati					1221			1221
Proteza mobile të skeletuara					251			251
Punim fiks protetikor Kurora					2781			2781
Rindërtime	11				117			128
Trajtime për fëmijët me nevoja të veçanta	293	1	1					295
Trajtimi me ndihmën e sedacionit inhalator	24	1						25
Mbushje amalgami	101					547		648
Mbushje kompoziti	3281	2			33	8583	3	11902
Mbushje endodontike	279	4				2052		2335
Nxjerrje e dhëmbëve	2607	6387		3			22	9019
Nxjerrje kirurgjike e dhëmbëve		612						612
Trajtim i alveolitit	5	2						7
Intervenime kirurgjike me laser				67				67
Intervenime kirurgjike me llambo		2		339				341
Intervenime kirurgjike mukogingivale (frenektomi klasike, thellim vestibulumi klasik)				2				2
Intervenime kirurgjike të cystave nofulllore		69						69
Apikotomi		93						93
Intervenime kirurgjike të tumoreve të indeve të buta		31		7				38
Largim i depozitimeve të forta	270			5920		4		6194
Kiretazhë e xhëpave parodontal	8	3		2840				2851
Gingivektomi me plastikë		1		58				59
Trajtim preventiv i dhëmbëve	471							471
Te tjera	21954	21198	30986	9191	28722	25779	4004	141834
PRF		10						10
Terapia regjenerative me PRF				3				3
Intervenime kirurgjik me llambo-Terapi regjenerative-Kockë artificiale		1		29				30
Numri total i shërbimeve:	42082	45423	48371	23996	48021	48064	17450	273407




4. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Spitalet e përgjithshme të SHSKUK

Shërbimet Shëndetësore në Spitalet e Përgjithshme të SHSKUK Janar-Dhjetor 2025								
Indikatoret e performancës	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Vushtrri	Prizren	Gjakovë	Ferizaj	Gjithsej
BOR (shfrytëzueshmëria e shtretëve)	40%	60%	45%	57%	43%	37%	70%	45%
ALOS (kohëzgjatja e qëndrimit të pacientit/ës në spital)	3.34	3.98	4.89	4.1	3.57	3.96	3.65	3.90
Vizita ambulantore	148736	211197	136292	56648	194424	105437	102515	955249
Tomografi e Kompjuterizuar (CT-ja)	3847	3726	5178	1344	3489	4596	3853	26033
Mamografi	1101	283	664	303	645	0	284	3280
Ultrazë (numri total i ofruar në të gjitha repartet)	23470	5511	29137	8064	24124	15957	23710	129973
EKG (numri total i ofruar në të gjitha repartet)	27208	13341	29947	10000	20582	22052	15697	138827
Elektroencefalografia (EMNG-ja)	0	0	125	0	257	179		561
Electroencefalografia (EEG-ja)	287	193	0	0	203	448		1131
Operacione (numri total i ofruar në të gjitha repartet)	2267	3369	3269	1101	4295	2036	1873	18210
Rentegen nativ (RTG-ja)	16299	18951	27023	5752	20372	15696	13922	118015
Rezonanca Magnetike (MRI)	0	0	1509	0	3490	0	0	4999
Laborator (Parametrat laboratorik)	201189	397880	1007780	76065	643598	489519	140624	2956655
Ekokardiografi	1900	2669	2597	501	1676	1002	883	11228
Stress Test (tredmil)	0	0	1008	214	225	0	0	1447
Holter kardiak	0	99	0	88	255	0	0	442
Fëmijet e lindur	1304	1744	1300	69	2421	1550	1175	9563
Numri i lindjeve	1292	1716	1289	69	2398	1532	1169	9465
Lindjet me CS	548	730	634	27	975	517	284	3715
% e lindjeve me CS	42%	43%	49%	39%	41%	34%	24%	39%
Dializa	6184	13417	11252	0	29960	9342	11594	81749
Numri i pacientëve të shtrirë	14072	10856	13076	3122	19102	14705	4308	79241
Ditët e shërimit	46942	43208	63896	13083	68131	58176	15734	309170
Nr i vdekjeve	206	201	315	68	401	297	65	1553
% e të vdekurve në raport me numrin e të shtrirëve	1%	2%	2%	2%	2%	2%	2%	2%
Koronarografi					690	0	0	690
Stent					201	0		201
Gastroskopi	304	733	473	234	613	5	247	2609
Kolonoskopi	162	263	186	0	89	0	132	832

Tabela e lartë shënuar, përmbledh punën e realizuar në shtatë spitale të përgjithshme të cilat operojnë në Republikën e Kosovës dhe janë në kuadër të SHSKUK

4.1. Efikasiteti i Shërbimeve

Shfrytëzueshmëria e Shtretërve (BOR)



Nga të gjithë shtetet e shtatë spitaleve të përgjithshme kemi shfrytëzueshmëri të shtretërve me 48% në të gjitha njësitë spitalore.


Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj ka shfrytëzueshmërinë më të lartë, me **70%**, duke u shfrytëzuar në mënyrë efikase, megjithëse numri i përgjithshëm i tyre është më i vogël me gjithsej 62 shtretër. **Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri** renditet i dyti me një BOR prej **57%**, duke reflektuar një menaxhim efikas për një numër të kufizuar shtretërish. **Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë** ka një shfrytëzueshmëri të qëndrueshme me 60%, mbi mesataren kombëtare.

Spitalet e Përgjithshme në Gjilani, Gjakova, Peja dhe Prizreni kanë shfrytëzueshmëri më të ulët, përkatësisht rreth **37%-46%**, që sugjeron mundësi për optimizim të kapaciteteve ose nevoja për rritjen e kërkesës për shërbime spitalore në këto rajone.



Kohëzgjatja e Qëndrimit të Pacientëve (ALOS)

Mesatarja e përgjithshme e ALOS është 3.9 ditë. Spitali i Përgjithshëm në Pejë ka kohëzgjatjen




më të lartë të qëndrimit (4.89 ditë), ndërsa Spitali i Përgjithshëm në **Prizren** ka kohëzgjatjen më të ulët (3.57 ditë). Kjo tregon se pacientët në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë kanë nevojë për trajtim më të gjatë, ndërsa pacientët në Prizren dhe Ferizaj përfundojnë trajtimin më shpejt.

Vizita Ambulatore

Totali i vizitave ambulantore është 934,718. Spitali i Përgjithshëm në Prizren ka numrin më të lartë të vizitave (194,424), ndërsa Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri ka numrin më të ulët (56,648). Kjo tregon për një realizim më të lartë për shërbimet ambulantore në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren dhe një realizim më të ulët në Spitalin e Përgjithshëm në Vushtrri.


Numri i Operacioneve



Totali i operacioneve është 18,210, Spitali i Përgjithshëm në Prizren ka numrin më të lartë të operacioneve (4295), ndërsa Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri ka numrin më të ulët (1101). Kjo tregon për një aktivitet më të lartë kirurgjikal në Prizren dhe një aktivitet shumë më të ulët në Spital të Përgjithshëm në Vushtrri.



Lindjet



Totali i lindjeve është 9465, me 3715 prej tyre të kryera me ndërhyrje CS (39%). Spitali i Përgjithshëm në Prizreni ka numrin më të lartë të lindjeve (2398), ndërsa Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri ka numrin më të ulët (49).

4.2. Cilësia e Shërbimeve

1. Numri i Vdekjeve dhe Përqindja e Vdekjeve

- ❖ Totali i vdekjeve është 1553, që përfaqëson 2% të numrit të pacientëve të shtrirë. Spitali i Prizrenit ka numrin më të lartë të vdekjeve (401), ndërsa Spitali i Ferizajit ka numrin më të ulët (65).

2. Numri i Ditët e Shërimit

Numri i pacientëve të shtrirë: 79,241.

Ditët e shërimit: 309,170 gjithsej.

3. Numri i parametrave laboratorik:



Janë kryer 2,956,655 parametra laboratorike në të gjitha spitalet, me Pejën që realizon më shumë se 1,007,780 analiza.

4. Shërbime diagnostikuese:

CT (Tomografi e Kompjuterizuar) gjithsej 26,033

- Spitali i Pejës e ka numrin më të lartë të ofrimit të këtij shërbimi me gjithsej 5178 ekzaminime.

Mamografi gjithsej-3280

MRI dhe RTG

- MRI ka përdorim të përqendruar vetëm në Spital të Pejës dhe Prizrenit me gjithsej 4999 ekzaminime.
- RTG përdoret gjerësisht në të gjitha spitalet me gjithsej 118,015 ekzaminime.

4.3. Shërbimet e ofruara sipas Spitaleve të Përgjithshme

Spitali i Përgjithshëm në Prizren

KATEGORIA	INDIKATORI	VLERA
KAPACITET & SHTRIM	BOR (shfrytëzueshmëria e shtretërve)	43%
	ALOS (ditë qëndrimi mesatar)	4.4 ditë
	Numri i pacientëve të shtrirë	19,102
	Ditë shërimi	68,131
AMBULANTA DIAGNOSTIKA	Vizita ambulantore	194,424
	Laborator (parametra laboratorik)	634,955
	RTG	20,372
	CT	3,489
	MRI	3,490
	Ultrazë	24,124
	EKG	20,582
	Ekokardiografi	1,676
	EEG	203
	EMNG	257
	Holter kardiak	255
	Stress Test	225
KIRURGJIA & INVAZIVE	Operacione	4,295
	Koronarografi	690
	Angiografi	0
	Dializa (seanca)	29,960
OBSTETRIKA	Numri i lindjeve	2,421
	Fëmijë të lindur	2,398
	Lindje me CS	975

Gjatë vitit raportues 2025, Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit ka shënuar një volum të konsideruar të aktivitetit shëndetësor, duke konfirmuar rolin e tij si qendër e rëndësishme rajonale e SHSKUK-së.

Shfrytëzimi i shtretërve (BOR) prej 43% dhe qëndrimi mesatar i pacientëve prej 3.9 ditësh tregojnë rrjedhshmëri të mirë të pacientëve dhe menaxhim relativisht efikas të kapaciteteve spitalore, megjithëse ekziston potencial për optimizim të mëtejshëm të përdorimit të shtretërve.

Me 19,102 pacientë të shtrirë dhe 68,131 ditë shërimi, spitali ka përballuar një ngarkesë të konsiderueshme klinike. Aktiviteti ambulator ka qenë i lartë, me 194,424 vizita, duke dëshmuar rolin kyç të spitalit në ofrimin e shërbimeve sekondare për rajonin.

Në aspektin diagnostik, laboratorit me 634,955 parametra laboratorik dhe radiologjia (RTG, CT, MRI, ultrazë) përbëjnë shtyllën kryesore të volumit të punës, duke e bërë spitalin një pikë referimi për diagnostikë.



Aktiviteti kirurgjik me 4,295 operacione dhe 690 koronarografi, si dhe 29,960 seanca dialize, dëshmojnë për profil të fortë terapeutik dhe invaziv të institucionit.

Në fushën e obstetrikës janë realizuar 2,421 lindje, nga të cilat 975 me prerje cezariene, që përbën rreth 40% të lindjeve.

Spitali i Përgjithshëm në Pejë

Tabela Përmbledhëse e Indikatorëve të performancës

KATEGORIA	INDIKATORI	VLERA
KAPACITET & SHFRYTËZIM	BOR (shfrytëzueshmëria e shtretërve)	45%
	ALOS (ditë qëndrimi mesatar)	4.89 ditë
	Numri i pacientëve të shtrirë	13,076
	Ditë shërimi	63,896
AMBULANTA	Vizita ambulatore	136,292
DIAGNOSTIKA	Laborator (parametra laboratorik)	1,155,000
	RTG	27,023
	CT	5,178
	MRI	1,509
	Ultrazë	37,965
	EKG	29,947
	Ekokardiografi	2,597
	EEG	0
	EMNG	125
	Holter kardiak	0
	Stress Test	1,008
	Operacione	3,269
KIRURGJIA / ENDOSKOPIA	Gastroskopi	473
	Kolonoskopi	186
	Angiografi	0
NEFROLOGJIA	Dializa (seanca)	11,252
OBSTETRIKA	Numri i lindjeve	1,300
	Fëmijë të lindur	1,289
	Lindje me CS	634

Gjatë vitit 2025, Spitali i Përgjithshëm i Pejës ka shënuar një nivel të lartë dhe të qëndrueshëm të aktivitetit klinik dhe diagnostik, duke u konfirmuar si një nga spitalet më të ngarkuara në kuadër të SHSKUK-së.

Me një BOR prej 45% dhe ALOS prej 4.89 ditësh, spitali tregon shfrytëzim mesatar të kapaciteteve spitalore dhe një kohë qëndrimi relativisht të gjatë, që reflekton profilin e rasteve më komplekse dhe nevojën për trajtime më të gjata.

Gjatë vitit janë trajtuar 13,076 pacientë të shtrirë, me gjithsej 63,896 ditë shërimi, që dëshmon për ngarkesë të konsiderueshme të repartëve spitalorë.



Aktiviteti ambulator ka qenë i lartë, me 136,292 vizita, ndërsa diagnostika paraqet një volum shumë të madh pune:

- 37,965 ultrazë
- 29,947 EKG
- 27,023 RTG
- 5,178 CT dhe 1,509 MRI
- Mbi 1.15 milion parametra laboratorike

Në aspektin terapeutik dhe kirurgjik janë realizuar:

- 3,269 operacione
- 473 gastroskopi dhe 186 kolonoskopi
- 11,252 seanca dialize, që e bën Pejën një nga qendrat më të ngarkuara për nefrologji në SHSKUK

Në fushën e obstetrikës janë realizuar 1,300 lindje, nga të cilat 634 me prerje cezariane (49%), përqindje e lartë që kërkon analizë të vazhdueshme klinike dhe menaxheriale të indikacioneve për CS.

Spitali i Përgjithshëm Gjakovë

Tabela përmbledhëse e Indikatorëve të Performancës

KATEGORIA	INDIKATORI	VLERA
KAPACITET & SHFRYTËZIM	BOR (shfrytëzueshmëria e shtretërve)	37.4%
	ALOS (ditë qëndrimi mesatar)	4.0 ditë
	Numri i pacientëve të shtrirë	14,705
	Ditë shërimi	58,176
AMBULANTA DIAGNOSTIKA	Vizita ambulantore	105,437
	Laborator (parametra laboratorik)	489,519
	RTG (Rëntgen)	15,696
	CT	4,596
	MRI	0
	Ultrazë	15,957
	EKG	22,052
	Ekokardiografi	1,002
	EEG	448
	EMNG	179
	Stress Test	0
	Holter kardiak	0
	Angiografi	0
	Operacione	2,036
KIRURGJIA NEFROLOGJIA OBSTETRIKA	Dializa (seanca)	9,342
	Lindjet (fëmijë të lindur)	1,550
	Numri i lindjeve	1,532
	Lindje me CS	517

Gjatë periudhës raportuese, Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë ka ofruar një gamë të gjerë shërbimesh shëndetësore, duke përfshirë shërbime spitalore dhe ambulatorë. Indikatorët kryesorë të performancës tregojnë për një aktivitet të qëndrueshëm në ofrimin e kujdesit shëndetësor.

Me një BOR prej 37.4%, spitali tregon se kapacitetet e shtretërve nuk janë të shfrytëzuara në nivel optimal, çka sugjeron hapësirë për rritje të hospitalizimeve ose riorganizim të rrjedhës së pacientëve nga nivelet tjera të kujdesit shëndetësor.

ALOS prej 3.96 ditësh tregon një qëndrim mesatar relativisht të shkurtër dhe efikas, që nënkupton menaxhim të mirë të rasteve akute dhe kronike pa zgjatje të panevojshme të hospitalizimit.

Gjatë vitit janë trajtuar:

- 14,705 pacientë të shtrirë
- 58,176 ditë shërimi
- 105,437 vizita ambulantore

Në aspektin diagnostik, aktiviteti është shumë intensiv:



- 489,519 analiza laboratorike
- 15,696 RTG, 15,957 ultrazë, 4,596 CT
- 22,052 EKG dhe 1,002 ekokardiografi

Në aspektin terapeutik:

- 2,036 operacione kirurgjikale
- 9,342 seanca dialize, që tregon ngarkesë të lartë të shërbimit të nefrologjisë

Në obstetrikë janë realizuar:

- 1,532 lindje, me 517 lindje me prerje cezariane (~34%), që paraqet një përqindje klinikisht të arsyeshme, por që kërkon monitorim të vazhdueshëm.

Spitali i Përgjthshëm Gjilan

Tabela e përmblodhur e indikatorëve kyç të performancës spitalore:

KATEGORIA	INDIKATORI	VLERA
KAPACITET & SHFRYTËZIM	BOR (shfrytëzueshmëria e shtretërve)	46%
	ALOS (ditë qëndrimi mesatar)	3.34 ditë
	Numri i pacientëve të shtrirë	14,072
	Ditë shërimi	46,942
	Nr i vdekjeve	206
	Shkalla e vdekshmërisë	1%
AMBULANTA	Vizita ambulantore	148,736
DIAGNOSTIKA	Laborator (parametra laboratorik)	201,189
	RTG	16,299
	CT	3,847
	MRI	0
	Ultrazë	23,470
	EKG	27,208
	Ekokardiografi	1,900
	EEG	287
	EMNG	0
	Stress test	554
	Holter	0
	Mamografi	1,101
KIRURGJIA	Operacione	2,267
NEFROLOGJIA	Dializa (seanca)	6,184
OBSTETRIKA	Fëmijë të lindur	1,304
	Numri i lindjeve	1,292
	Lindje me CS	548
	% e lindjeve me CS	42%



Gjatë vitit 2025, Spitali i Përgjithshëm i Gjilanit ka zhvilluar një aktivitet të gjerë klinik, diagnostik dhe ambulator, duke ofruar shërbime shëndetësore për një numër të madh pacientësh dhe duke luajtur një rol të rëndësishëm në mbulimin e nevojave shëndetësore të rajonit.

Shfrytëzueshmëria e shtretërve (BOR) prej 46% tregon se kapacitetet spitalore janë të shfrytëzuara nën nivelin optimal. Ky tregues sugjeron nevojën për rishikim të organizimit të shërbimeve spitalore, forcim të rolit referues të spitalit dhe optimizim të përdorimit të kapaciteteve ekzistuese.

Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të pacientëve në spital (ALOS) prej 3.34 ditësh tregon një efikasitet të mirë të menaxhimit klinik dhe qarkullim relativisht të shpejtë të pacientëve, duke reflektuar organizim të mirë të trajtimit dhe lirimit spitalor.

Gjatë vitit raportues janë trajtuar gjithsej 14,072 pacientë të shtrirë, ndërsa janë realizuar 46,942 ditë shërimi. Paralelisht, janë ofruar 148,736 vizita ambulantore, çka dëshmon për një ngarkesë shumë të lartë të shërbimeve jashtëspitalore dhe rolin e rëndësishëm të spitalit në trajtimin ambulator.

Aktiviteti diagnostik ka qenë shumë i zhvilluar, me 201,189 parametra laboratorike, 16,299 ekzaminime me rentgen, 23,470 ultrazë, 3,847 tomografi të kompjuterizuara, si dhe 27,208 EKG dhe 1,900 ekokardiografi. Këto të dhëna tregojnë për një varësi të lartë të shërbimeve klinike nga diagnostika dhe për një volum të konsiderueshëm pune në shërbimet mbështetëse.

Në aspektin kirurgjikal, gjatë vitit janë realizuar 2,267 operacione, ndërsa shërbimi i dializës ka ofruar 6,184 seanca, duke dëshmuar për një ngarkesë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme të këtij shërbimi.

Në fushën e obstetrikës janë realizuar 1,292 lindje, nga të cilat 548 kanë qenë me prerje cezariene, që përbëjnë 42% të totalit të lindjeve. Ky nivel relativisht i lartë i lindjeve me operacion kërkon vlerësim të vazhdueshëm profesional dhe analizë të indikacioneve klinike.

Gjatë vitit janë regjistruar 206 raste vdekjeje, që përfaqëson rreth 1% të pacientëve të shtrirë, një nivel i ulët që reflekton cilësi të kënaqshme të trajtimit spitalor dhe menaxhim adekuat të rasteve klinike.



Spitali i Përgjithshëm Mitrovicë

Tabela e përmblodhur e indikatorëve kyç të performancës spitalore

INDIKATORI	VLERA
BOR (SHFRYTËZUESHMËRIA E SHTRETËRVE)	60%
ALOS (KOHËZGJATJA MESATARE E QËNDRIMIT)	3.98 ditë
VIZITA AMBULANTORE	190,666
TOMOGRAFI E KOMPJUTERIZUAR (CT)	3,726
MAMOGRAFI	283
ULTRAZË	5,511
EKG	13,341
ELEKTRONEUROMIOGRAFI (EMNG)	0
ELEKTROENCEFALOGRAFI (EEG)	193
OPERACIONE (TOTAL)	3,369
RENTGEN NATIV (RTG)	18,951
REZONANCË MAGNETIKE (MRI)	0
LABORATOR (PARAMETRA LABORATORIK)	397,880
EKOKARDIOGRAFI	2,669
STRESS TEST	0
HOLTER KARDIAK	99
FËMIJË TË LINDUR	

Gjatë vitit 2025, Spitali i Përgjithshëm i Mitrovicës ka zhvilluar një aktivitet të qëndrueshëm dhe të gjerë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për popullatën e rajonit, duke mbuluar një gamë të gjerë shërbimesh spitalore, ambulantore, diagnostike dhe terapeutike.

Shfrytëzueshmëria e shtretërve (BOR) prej 60% paraqet një nivel relativisht të mirë të përdorimit të kapaciteteve spitalore dhe tregon se spitali ka një rol të rëndësishëm në trajtimin stacionar të pacientëve në nivel rajonal. Ky nivel i shfrytëzimit sugjeron një balancë të mirë ndërmjet kapaciteteve ekzistuese dhe kërkesës për shërbime spitalore.

Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të pacientëve në spital (ALOS) prej 3.98 ditësh tregon një menaxhim relativisht efikas të rasteve klinike dhe një rrjedhë të qëndrueshme të hospitalizimeve, duke ruajtur një ekuilibër ndërmjet trajtimit adekuat dhe lirimit në kohë të pacientëve.

Gjatë vitit janë trajtuar gjithsej 10,856 pacientë të shtrirë, me gjithsej 43,208 ditë shërimi, ndërsa janë realizuar 190,666 vizita ambulantore, çka dëshmon për një ngarkesë të konsiderueshme si në shërbimet spitalore ashtu edhe në ato ambulantore.

Aktiviteti diagnostik ka qenë i zhvilluar, me 397,880 analiza(parametra) laboratorike, 18,951 ekzaminime me rentgen, 5,511 ultrazë, 3,726 tomografi të kompjuterizuara, si dhe 13,341 EKG dhe 2,669 ekokardiografi. Këta tregues konfirmojnë rolin kyç të diagnostikës në funksionimin klinik të spitalit.

Në aspektin kirurgjikal, gjatë vitit janë realizuar 3,369 operacione, duke e renditur Spitalin e Mitrovicës ndër qendrat me volum të lartë të aktivitetit kirurgjikal në kuadër të spitaleve të përgjithshme.

Në fushën e nefrologjisë, janë realizuar 13,417 seanca të dializës, që paraqet një ngarkesë të lartë dhe të vazhdueshme të këtij shërbimi jetik.

Në aspektin obstetrik, janë regjistruar 1,716 lindje, prej të cilave 730 kanë qenë me prerje cezariane, që përbën 43% të totalit të lindjeve. Ky nivel kërkon vlerësim të vazhdueshëm profesional të indikacioneve klinike dhe monitorim të praktikave obstetrike.

Gjatë vitit janë regjistruar 201 raste vdekjeje, që përbëjnë rreth 2% të pacientëve të shtrirë, një nivel që kërkon analizë të vazhdueshme të profileve klinike dhe kompleksitetit të rasteve të trajtuara.

Spitali i Përgjithshëm Vushtrri

Në periudhën janar-dhjetor 2025, nga permbledhja e indikatorët e performancës së spitalit shfaqen si më poshtë:

INDIKATORI	VLERA
BOR (SHFRYTËZUESHMËRIA E SHITRËTËRVE)	57%
ALOS (KOHËZGJATJA MESATARE E QËNDRIMIT)	4.1 ditë
VIZITA AMBULANTORE	56,648
TOMOGRAFI E KOMPJUTERIZUAR (CT)	1,344
MAMOGRAFI	303
ULTRAZË	8,064
EKG	10,000
ELEKTRONEUROMIOGRAFI (EMNG)	0
ELEKTROENCEFALOGRAFI (EEG)	0
OPERACIONE (TOTAL)	1,101
RENTGEN NATIV (RTG)	5,752
REZONANCË MAGNETIKE (MRI)	0
LABORATOR (PARAMETRA LABORATORIK)	76,065
EKOKARDIOGRAFI	501
STRESS TEST	214
HOLTER KARDIAK	88
FËMIJË TË LINDUR	69
NUMRI I LINDJEVE	69
LINDJE ME CS	27
% E LINDJEVE ME CS	39%
DIALIZA	0
NUMRI I PACIENTËVE TË SHTRIRË	3,122
DITËT E SHËRIMIT	13,083
NR. I VDEKJEVE	68
% E VDEKJEVE NDAJ TË SHTRIRËVE	2%
KORONAROGRAFI	0

STENT

0

GASTROSKOPI

234

Gjatë vitit raportues, Spitali i Përgjithshëm i Vushtrisë ka ofruar shërbime shëndetësore në një nivel të qëndrueshëm dhe funksional, duke mbuluar nevojat bazike spitalore të popullatës së rajonit, me fokus në shërbimet ambulatorë, diagnostike dhe hospitalore.

Shfrytëzueshmëria e shtretërve (BOR) ka arritur në **57%**, që tregon një nivel relativisht të mirë të përdorimit të kapaciteteve spitalore, ndërsa **kohëzgjatja mesatare e qëndrimit (ALOS) prej 4.1 ditësh** sugjeron një menaxhim të balancuar të rasteve spitalore dhe rrjedhës së pacientëve.

Gjatë vitit janë realizuar gjithsej **56,648 vizita ambulatorë**, çka dëshmon për një ngarkesë të konsiderueshme të shërbimeve jashtëspitalore dhe një rol të rëndësishëm të këtij spitali në trajtimin primar dhe sekondar të pacientëve.

Në aspektin diagnostik, spitali ka kryer një volum të konsiderueshëm ekzaminimesh: **8,064 ultrazëra, 10,000 EKG, 5,752 RTG, 1,344 CT**, si dhe **76,065 analiza laboratorike**, duke e bërë laboratorin dhe shërbimet bazike diagnostike shtyllë kryesore të punës klinike.

Në fushën kirurgjikale janë realizuar **1,101 operacione**, që përfaqëson një aktivitet kirurgjikal funksional, por me hapësirë për rritje të mëtejshme në të ardhmen, veçanërisht nëse rriten kapacitetet teknike dhe njerëzore.

Sa i përket shërbimeve kardiologjike, janë realizuar **501 ekokardiografi, 214 stress-teste dhe 88 Holter**, që tregon një shërbim bazik, por ende të kufizuar në krahasim me nevojat potenciale të popullatës.

Në aspektin obstetrik, janë regjistruar **69 lindje**, prej të cilave **39% janë realizuar me prerje cezariene**, përqindje kjo që mbetet brenda kufijve të pranueshëm klinikë, por që duhet monitoruar në vazhdimësi.

Gjatë vitit janë trajtuar **3,122 pacientë të shtrirë**, me gjithsej **13,083 ditë shërimi**, ndërsa **norma e vdekshmërisë prej 2%** në raport me pacientët e shtrirë konsiderohet relativisht stabile dhe në përputhje me profilin e shërbimeve që ofron spitali.

Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj

Tabela Përmbledhëse e indikatorëve kyç të performancës

INDIKATORI	VLERA
BOR (SHFRYTËZUESHMËRIA E SHTRETËVE)	70%
ALOS (DITË)	3.65
VIZITA AMBULANTORE	102,515
CT	3,853
MAMOGRAFI	284
ULTRAZË	23,710



EKG	15,697
OPERACIONE	1,873
RTG	13,922
ANALIZA LABORATORIKE	140,624
EKOKARDIOGRAFI	883
FËMIJË TË LINDUR	1,175
NUMRI I LINDJEVE	1,169
LINDJE ME CS	284
% LINDJEVE ME CS	24%
DIALIZA	11,594
PACIENTË TË SHTRIRË	4,308
DITË SHËRIMI	15,734
VDEKJE	65
VDEKSHMËRIA SPITALORE	2%
GASTROSKOPI	247
KOLONOSKOPI	132

Gjatë vitit raportues, Spitali i Përgjithshëm i Ferizajt ka shënuar nivel shumë të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve spitalore, me BOR prej 70%, që përfaqëson një nga normat më të larta të përdorimit të shtretërve në rrjetin e spitaleve të përgjithshme të SHSKUK. Kjo dëshmon për ngarkesë të lartë spitalore dhe rol kyç rajonal të këtij spitali.

ALOS prej 3.65 ditësh tregon një menaxhim relativisht efikas të qëndrimeve spitalore dhe qarkullimit të pacientëve.

Gjatë vitit janë realizuar 102,515 vizita ambulantore, që konfirmon një volum të lartë të shërbimeve ambulatorie dhe një rol të rëndësishëm të spitalit në trajtimin ditor të pacientëve.

Në aspektin diagnostik, spitali ka kryer:

- 23,710 ultrazëra,
- 15,697 EKG,
- 13,922 RTG,
- 3,853 CT,
- si dhe 140,624 analiza (parametra) laboratorike, duke e pozicionuar laboratorin dhe diagnostikën bazike si shtyllë kryesore të aktivitetit klinik.

Në fushën kirurgjikale janë realizuar 1,873 operacione, që paraqet një volum të konsiderueshëm ndërhyrjesh, por ende me hapësirë për rritje të mëtejshme në të ardhmen.

Në shërbimet kardiologjike janë realizuar 883 ekokardiografi, ndërsa mungojnë shërbime si stress test dhe Holter, që tregon nevojë për zgjerim të kapaciteteve funksionale kardiologjike.



Në shërbimin obstetrik janë regjistruar 1,169 lindje, me 1,175 fëmijë të lindur, prej të cilave 24% kanë qenë me prerje cezariene, përqindje kjo më e ulët se mesatarja e rrjetit spitalor, dhe klinikisht e favorshme.

Spitali ka trajtuar 4,308 pacientë të shtrirë, me gjithsej 15,734 ditë shërimi, ndërsa norma e vdekshmërisë prej 2% mbetet stabile dhe në përputhje me profilin e shërbimeve të ofruara.

5. Qendrat e shendetit mendor me Shtëpi Integruese në Bashkesi dhe QIRSKP Shtime

Nr	Njesia	Vizita Shtepiake	Qendrimet Ditore	Vizita/specialistike (psikiatrike-psikologut)	Terapi okupuese,art, sporte,argetime etj)	Shërbime të punëtorit social	Total
1	QSHMSHIB-Prishtinë	1,290	4,001	8,163	3,281	1,995	18,730
2	QShMSHIB- Ferizaj	417	1,270	4,165	2,471	52	8,375
3	QSHMSHIB-Mitrovicë	960	4,646	4,725	9,109	-	19,440
4	QSHMSHIB-Gjilan	1,410	1,296	2,353	11,860	2,806	19,725
5	QSHMSHIB-Pejë	631	2,148	1,272	5,080	81	9,212
6	QSHMSHIB-Gjakovë	622	2,050	3,438	9,535	-	15,645
7	QSHMSHIB-Prizren	420	2,568	4,803	13,743	-	21,534
8	QIRSKP-Shtime			585	668	106	
	Total	5,750	17,979	29,504	55,747	5,040	114,020

Kjo tabelë përmban të dhëna për shërbimet e ofruara nga Qendrat e Shërbimeve Shëndetësore Mendore dhe Sociale me Bashkesi (QSHMSHIB dhe QIRSKP Shtime) në disa rajone të Kosovës gjatë periudhës Janar-dhjetor 2025. Të dhënat përfshijnë numrin e vizitave shtëpiake, qendrimet ditore, vizitat ambulantore, terapitë okupuese, shërbimet e punëtorit social, pacientët e shtrirë dhe ditët e shërimit.

Vizitat Shtëpiake: Qendra ne Gjilan ka numrin më të lartë të vizitave shtëpiake (1410), duke treguar përfshirjen e madhe në shërbimet e komunitetit.

Qendrimet Ditore: Mitrovica dhe Peja kryesojnë me qendrimet ditore, duke treguar përkrahjen intensive të ditës për pacientët e tyre.

Terapitë Okupuese dhe te tjera: Qendra ne Prizren ka numrin më të lartë të terapive okupuese (13,743), duke u fokusuar në aktivitete të ndryshme për mirëqenien e pacientëve.

Shërbimet e Punëtorit Social: Prishtina dhe Gjilani kanë shërbime të konsiderueshme të punëtorit social, me Gjilanin që udhëheq me 2,806 shërbime.

6. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës (QKMP) Gjakovë

SHËRBIMI	NUMRI
INDIKATORËT E PUNËS DIAGNOSTIKË	
VIZITA AMBULANTORE	32,974
VIZITA DIAGNOSTIKE	35,268
VIZITA SISTEMATIKE ME PREZENCË	2088
VIZITA SISTEMATIKE ME KONSULENCË	857
SHËRBIMET LABORATORIKE - BIOKIMIA	
NUMRI I PACIENTËVE	7,309
ANALIZAT E REALIZUARA	103,635
ULTRAZË	301
RADIOGRAFI	3994
TË TJERA (DENSITOMETRISË)	1856

Gjatë vitit 2025, Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës (QKMP) Gjakovë ka ofruar shërbime të gjera diagnostike, laboratorike dhe imazherike, duke kontribuar ndjeshëm në mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit në punë.

Janë realizuar 32,974 vizita ambulantore dhe 35,268 vizita diagnostike, si dhe 2,945 vizita sistematike (me prezencë dhe konsulencë). Në shërbimet laboratorike janë trajtuar 7,309 pacientë me gjithsej 103,635 analiza biokimike.

Në kuadër të diagnostikës imazherike janë kryer 301 ultrazë, 3,994 radiografi dhe 1,856 ekzaminime të densitometrisë. Këto të dhëna dëshmojnë angazhimin e vazhdueshëm të QKMP Gjakovë në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe preventive për punëmarrësit.

7. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive (QKMS)

Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive ka treguar një nivel të lartë efikasiteti dhe përkushtimi në ofrimin e shërbimeve të tyre. Numri i madh i sportistëve të kontrolluar tregon për rëndësinë e këtyre kontrolleve në ruajtjen e shëndetit të sportistëve.

Gjithsej janë realizuar 20,699 vizita profesionale për komunitetin sportiv.

- Stres testi gjithsej 122 raste me percjellje me EKG
- Astrand testi me biciklet gjithsej 3878 me percjellje me monitor EKG ● Shkolla të sporteve të ndryshme gjithsej 16259 (8 vjet-17 vjet).



Shpërndarja e sportistëve sipas sportit / kategorisë

Sporti me përfaqësimin më të lartë është futbollit, me gjithsej 18,910 sportistë, duke dominuar ndjeshëm strukturën e përgjithshme të sportistëve të regjistruar. Pas futbollit, hendbolli përfaqësohet me 365 sportistë, ndërsa basketbolli numëron 256 sportistë. Në sportet ujore, noti ka 158 sportistë të regjistruar.

Në kategoritë tjera, studentët sportistë përfaqësohen me 116 persona, boksi me 92 sportistë, ndërsa ping pongu me 79 sportistë. Sportet individuale përfshijnë 34 sportistë, karateja numëron 27 sportistë, dhe auto klubet përfaqësohen me 21 pjesëmarrës.


Krahas sportistëve aktivë, janë të regjistruar edhe 557 gjyqtarë sportivë, të cilët përbëjnë një kategori mbështetëse të rëndësishme për funksionimin dhe organizimin e aktiviteteve sportive.

QKMP ka ofruar edhe 361 vizita specialitike dhe 223 terapi fizikale.

8. Poliklinika Specialistike e Podujevës (SHSKUK)

Gjatë periudhës së raportuar Shtator–Dhjetor 2025, Poliklinika Specialistike e Podujevës, në kuadër të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), ka funksionuar në mënyrë të rregullt dhe të qëndrueshme, duke siguruar ofrimin e shërbimeve shëndetësore specialistike për popullatën e Komunës së Podujevës dhe zonave përreth.

Njësia e Hemodializës ka qenë funksionale me 16 aparatura aktive, duke ofruar trajtim të vazhdueshëm për 32 pacientë aktivë, ndërsa gjatë periudhës janë realizuar gjithsej 1,650 seanca të hemodializës. Paralelisht, Ambullantat Specialistike kanë ofruar shërbime në një gamë të gjerë fushash mjekësore, duke realizuar 4,019 vizita specialistike, me ngarkesë më të theksuar në kardiologji, ortopedi, gastroenterologji, neurologji dhe endokrinologji.



Në tërësi, Poliklinika ka kontribuar në rritjen e qasjes në shërbime specialistike, uljen e referimeve drejt qendrave terciare dhe përmirësimin e vazhdimësisë së kujdesit shëndetësor në nivel lokal, në përputhje me misionin dhe objektivat e SHSKUK-së



9. Menaxhimi Financiar 2025

Kategoria ekonomike	buxheti fillestar	Buxheti final	Shpenzimi	Mbetja	% e shfrytëzuar
Paga	94,561,890.00	98,980,865.05	98,975,903.15	4,961.90	100%
Mallra dhe shërbime	69,506,346.00	79,381,291.73	76,487,720.97	2,893,570.76	96%
Komunale	4,139,016.00	4,139,016.00	4,095,879.58	43,136.42	99%
Kapitale	22,449,500.00	21,186,232.81	17,602,229.85	3,584,002.96	83%
Gjithsej	190,656,752.00	203,687,405.59	197,161,733.55	6,525,672.04	97%

Gjatë periudhës raportuese, buxheti i alokuar është menaxhuar me efikasitet të lartë financiar, duke rezultuar me një normë të përgjithshme shfrytëzimi prej 97%. Nga buxheti final në vlerë **203,687,405.59 €**, janë shpenzuar **197,161,733.55 €**, ndërsa mbetja buxhetore ka qenë **6,525,672.04 €**.

Kategorite ekonomike:

Paga

Buxheti final për paga ka arritur në 98,980,865.05 €, nga të cilat janë shpenzuar 98,975,903.15 €, duke rezultuar në shfrytëzim pothuajse të plotë (100%). Mbetja minimale prej 4,961.90 € reflekton planifikim të saktë dhe kontroll të fortë të shpenzimeve për resurset njerëzore.

Mallra dhe shërbime


Në këtë kategori janë shfrytëzuar 76,487,720.97 € nga buxheti final 79,381,291.73 €, me një normë shfrytëzimi prej 96%. Mbetja prej 2,893,570.76 € lidhet kryesisht me racionalizimin e shpenzimeve dhe vonesa procedurale në disa aktivitete të prokurimit.

Shpenzime komunale

Shpenzimet komunale janë realizuar në vlerë 4,095,879.58 € nga buxheti i alokuar 4,139,016.00 €, duke arritur një nivel shfrytëzimi prej 99%. Kjo tregon menaxhim të qëndrueshëm dhe parashikim të saktë të nevojave operative.

Shpenzime kapitale

Nga buxheti final kapital prej 21,186,232.81 €, janë realizuar shpenzime në vlerë 17,602,229.85 €, që përfaqëson një normë shfrytëzimi prej 83%. Mbetja prej 3,584,002.96 € është rezultat i shtyrjes së disa projekteve kapitale, procedurave të prokurimit dhe dinamikave të realizimit të investimeve.




10. Furnizimi me barna dhe material shpenzues

Gjatë vitit 2025, Barnatorja Qendrore e SHSKUK-së ka siguruar furnizim përgjithësisht të qëndrueshëm me barna dhe materiale medicinale, pavarësisht rritjes së ndjeshme të shpenzueshmërisë dhe zgjerimit të Listës Esenciale. Përditësimi i Listës Esenciale dhe përfshirja e mbi 50 produkteve të reja medicinale kanë krijuar presion shtesë buxhetor, ndërkohë që rritja buxhetore nuk ka qenë proporcionale me nevojat reale të planifikimit.

Në vitin 2025, në nivel të SHSKUK-së:

- janë planifikuar 566 produkte medicinale, me vlerë financiare 31.3 milion €;
- 66% e produkteve medicinale janë të kontraktuara, ndërsa produktet me rëndësi vitale janë të kontraktuara mbi 90%;
- për shkak të mungesës së Autorizimit të Marketingut (AM), një pjesë e produkteve vitale mbetin pa kontratë;
- furnizimi me material medicinal paraqet performancë më të lartë, me 92% të materialeve të kontraktuara.



Një zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2025 është rritja e përdorimit të barnave biosimilare, veçanërisht te citostatikët, duke gjeneruar kursime të konsiderueshme buxhetore (p.sh. rasti i Bevacizumab-it). Megjithatë, sfidat kryesore vazhdojnë të mbeten procedurat e prokurimit, mungesa e ofertave për artikuj me vlerë të ulët dhe barrierat rregullative për importin e barnave.

Pavarësisht presionit buxhetor dhe zgjerimit të Listës Esenciale, SHSKUK ka arritur të ruajë furnizim të qëndrueshëm mbi 80% për barna dhe mbi 90% për material medicinal, duke garantuar terapitë vitale dhe duke realizuar kursime përmes biosimilarëve.

11. Donacionet:

Tremujori	Pajisje Mjekësore (€)	Produkte Mjekësore (€)	Të Tjera (€)	Totali (€)
TM1	91,981.80 €	588,434.37 €	10,897.89 €	691,314.06 €
TM2	222,171.03 €	3,318,544.32 €	16,342.69 €	3,557,058.04 €
TM3	151,835.56 €	2,512,048.32 €	24,988.00 €	2,688,871.88 €
TM4	1,046,985.97 €	2,048,725.45 €	157,739.30 €	3,253,450.72 €
Totali 2025	1,512,974.36 €	8,467,752.46 €	209,967.88 €	10,190,694.70 €

Gjatë vitit 2025, SHSKUK ka realizuar gjithsej 148 donacione me vlerë totale prej 10,190,694.70 €, të shpërndara në katër tremujorë me intensitet të ndryshëm financiar.

Produktet mjekësore përbëjnë komponentin kryesor të donacioneve, me 8.47 milion € (rreth 83% e totalit), duke reflektuar fokusin në furnizime dhe materiale klinike.

Pajisjet mjekësore arrijnë vlerën 1.51 milion € (rreth 15%), me rritje të ndjeshme në tremujorin e katërt, ku janë realizuar investime më të mëdha kapitale.

Kategoria “Të tjera” përfaqëson vetëm 2% të totalit financiar, por me numër relativisht të qëndrueshëm gjatë vitit.

Kategoria	Përmbajtja Kryesore	Fokusi Klinik	Vlera Totale (€)	% ndaj totalit
PRODUKTE MJEKËSORE	- Barna onkologjike dhe hematologjike (bortezomib, abiraterone, ibrutinib, bendamustine, posaconazole, etj.) - Barna për endokrinologji dhe diabetologji - Antibiotikë dhe terapi IV - Koncentrate për hemodializë (bikarbonat & acidik) - Reagjentë laboratorikë & kite diagnostike - Materiale sterile dhe barna pediatrike	Onkologji, Hematologji, Pediatri, Endokrinologji, Nefrologji, Mikrobiologji	8,467,752.46 €	83.1%
PAJISJE MJEKËSORE	- Pajisje diagnostike, terapeutike dhe laboratorike - Sisteme të avancuara teknologjike - Pajisje intervenuese dhe kirurgjikale	Kardiologji (Azurion 5 M12), Mikrobiologji (Biofire, Liaison XL), Neonatologji, Pediatri, Onkologji, Urologji, Hemodializë	1,512,974.36 €	14.8%
DONACIONE TË TJERA	- Materiale didaktike dhe lodra terapeutike - Mobilim dhe pajisje ndihmëse (divanë, rafte, kondicionerë) - Pajisje IT dhe sisteme sigurie - Pajisje mbështetëse për ambiente klinike	Psikiatri e Fëmijëve, QIRSKP, Kardiologji, Neonatologji, SP Gjilan, SP Prizren, Emergjencë	209,967.31 €	2.1%



TOTALI DONACIONEVE 2025	I		10,190,694.13 €	100%
-------------------------------	---	--	-----------------	------

Donacionet gjatë vitit 2025 kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e kapaciteteve të SHSKUK dhe njërive të saj përbërëse (QKUK, klinikat dhe spitalet e përgjithshme).

Përmes sigurimit të barnave esenciale (onkologji, hematologji, diabetologji, terapi IV dhe hemodializë) është garantuar vazhdimësia e trajtimit për pacientët me sëmundje kronike dhe malinje. Pajisjet diagnostike dhe terapeutike kanë modernizuar shërbimet në Kardiologji, Mikrobiologji, Neonatologji, Pediatri dhe Urologji, duke rritur cilësinë dhe sigurinë e kujdesit.

Njëkohësisht, donacionet kanë ulur barrën financiare mbi buxhetin publik, kanë përmirësuar kushtet infrastrukturore dhe kanë kontribuar në rritjen e efikasitetit operacional të institucioneve shëndetësore.

Në tërësi, donacionet përfaqësojnë mbështetje strategjike për avancimin e sistemit publik shëndetësor në Kosovë.

**12. Shërbimet e reja dhe konsoliduara në SHSKUK**

Njesia	Klinika/Njesia	Emërtimi i shërbimit ri/konsoliduar	Viti	Koment
QKUK	Klinika Alergologjis me Imunologji	Testime medikamentoze Peach test	2025	-
QKUK	Klinika Alergologjis me Imunologji	Testime Medikamentoze Prick test	2025	-
QKUK	Klinika Alergologjis me Imunologji	Testime medikamentoze IDR	2025	-
QKUK	Klinika Alergologjis me Imunologji	Testime medikamentoze mbingarkimit	2025	-
QKUK	Klinika Alergologjis me Imunologji	Testim i vaksinave COVID-19 (Prick)	2025	-
QKUK	Klinika Alergologjis me Imunologji	Testim i vaksinave COVID-19 (IDR)	2025	-
QKUK	Klinika Alergologjis me Imunologji	Testim i vaksinave MMR (Prick)	2025	-
QKUK	Klinika Alergologjis me Imunologji	Testim i vaksinave MMR (IDR)	2025	-
QKUK	Klinika Alergologjis me Imunologji	Trajtimi i angioedemës hereditare (HAE) me Ruconest® (C1-esterazë inhibitor rekombinant)	2025	-
QKUK	Klinika e Radiologjisë	Riaktivimi i shërbimit të STROK-ut	2025	-
QKUK	Klinika e Radiologjisë	Ri-aktivizimi i TK-Coronare	2025	-
QKUK	Neurologji	Vagal Nerve Stimulation (VNS)	2025	3 pacientët e parë; bashkëpunim me neurokirurg + Itali; trajnime Kroaci & Pragë
QKUK	Kardiokirurgji	Bentall + Supracoronary graft me hemiarch replacement (disekacione akute të aortës)	2025	Trajnime vetanake të stafit
QKUK	Gastroenterologji	EUS	2025	Aparaturë e sjellur; trajnime i stafit
QKUK	Gastroenterologji	Kapsulë endoskopike	2025	Aparaturë e sjellur; trajnime i stafit
QKUK	Mjekësia Fizikale & Rehabilitim	Osteodensitometria – DEXA	2025	
QKUK	Mjekësia Fizikale & Rehabilitim	Posturo-grafi	2025	Në pritje të trajnimit nga kompania



QKUK	Klinika Infektive	Trajtimi ambullantor i hepatiteve kronike	2025	-
QKUK	Klinika Infektive	QKTV – Qendra për këshillim & testim vullnetar	2025	-
QKUK	Klinika Infektive	QKTV – Shërbimi PrEP	2025	-
QKUK	Klinika Infektive	QKTV – Shërbimi PEP	2025	-
QKUK	Klinika Infektive	Kabineti i diagnostikës / Elastografia hepatale	2025	-
QKUK	Instituti i Anatomisë Patologjike	MMR (MLH1, PMS2, MSH2, MSH6) – IHC	2025	Status MSI për kancer kolorektal; orienton terapi
QKUK	Neonatologji	Skriningu neonatal metabolik	2025	Hapesira+aparatura+reagensa+trajnim; pritet zgjerim i pranimit të mostrave
QKUK	Pediatri – Kujdes Intensiv Pediatrik	CRRT (Continuous Renal Replacement Therapy)	2025	Donacion KFOR italian; trajnime Paris/Turqi/Itali/Shqipëri
QKUK	Pediatri – Kujdes Intensiv Pediatrik	Plazmafereza	2025	Donacion KFOR italian; trajnime Turqi/Itali/Shqipëri
QKUK	Pediatri – Kujdes Intensiv Pediatrik	Dializa peritoneale	2025	Materiale nga QKUK; trajnime Turqi/Shqipëri/Itali
QKUK	Pediatri – Hemato-Onkologji	Trajtimi i neuroblastomave	2025	-
QKUK	Pediatri – Endokrinologji	Sensorë CGM (FreeStyle Libre 2/3/3+)	2025	-
QKUK	Pediatri – Endokrinologji	Pompa insulinike Medtronic G720	2025	Trajnime; mundësuar nga AMC (donatore)
QKUK	Pediatri – Endokrinologji	i-Port te foshnjët me diabet neonatal	2025	Trajnime/udhëzime + qendra jashtë vendit
QKUK	Pediatri – Gastroenterologji kronike	IBD – Infliximab (amp)	2025	Sipas ESPGHAN
QKUK	Pediatri – Gastroenterologji kronike	Kapsullë endoskopike (monitorim Morbus Crohn)	2025	Rast i konfirmuar me biopsi
QKUK	Pediatri – Gastroenterologji kronike	Gastroskopi	2025	-
QKUK	Pediatri – Neurologji	Fillimi i plazmaferezës	2025	Për raste neurologjike; rezultat i trajnimeve
QKUK	Pediatri – Reumatologji	Terapia biologjike (Adalimumab)	2025	-
QKUK	Pediatri – Reumatologji	Terapia biologjike (Etanercept)	2025	-
QKUK	Pediatri – Reumatologji	Terapia biologjike (Tocilizumab)	2025	-



QKUK	Pediatri – Reumatologji	Terapia biologjike (Infliximab)	2025	-
QKUK	Kardiologji	Angio CT e arterieve koronare	2025	-
QKUK	Gjinekologji	Mjekësia fetale	2025	Aparaturë e re + trajnime
QKUK	Gjinekologji	Konsulta për IVF	2025	Aparaturë e re + trajnime
QKUK	Gjinekologji	Stimulime	2025	Aparaturë e re + trajnime
QKUK	Gjinekologji	Analiza spermogrami	2025	Aparaturë e re + trajnime
QKUK	Gjinekologji	Inseminime	2025	Aparaturë e re + trajnime
QKUK	Toksikologji	e-Screening në urinë (9 parametra)	2025	-
QKUK	Toksikologji	TDM + DOA (VITROS 4600)	2025	Gentamicin, Carbamazepine, etj.
QKUK	Urologji	Lithotripsia me laser	2025	Trajnim i stafit + furnizim me aparaturë
QKUK	Klinika e Syve	Angiografi retinës	Dhjetor 2025	Pajisja në montim final; pritjet funksionalizim
Poliklinika në Podujevë	Poliklinika Specialistike në Podujevë	Shërbimet e dializës	2025	Aparaturë e re + trajnime
Poliklinika në Podujevë	Poliklinika Specialistike në Podujevë	Shërbime ambulantore multispecialistike	2025	Investime infrastrukturore + aparaturë

Nr.	Njësia / Spitali	Klinika / Reparti	Shërbimi i ri/konsoliduar	Koment
1	QKSKUK	Ortopedia e nofullave	Analiza përmes Telerentgenit (S3621, S3623, S3624)	Përmes aparaturës
2	QKSKUK	Parodontologji & Mjekësi Orale	Aplikimi i PRF në trajtime kirurgjikale (S3537)	Aparaturë + përgatitje profesionale
3	QKSKUK	Parodontologji & Mjekësi Orale	PRF me terapi regjenerative (S3538)	Protokoll operativ
4	QKSKUK	Parodontologji & Mjekësi Orale	Spostim koronar i llambos (S3541)	Protokoll operativ
5	QKSKUK	Parodontologji & Mjekësi Orale	Regjenerim me membranë kolagjene (S3534)	Protokoll operativ
6	QKSKUK	Endodonci	Endomikroskop për trepanim/instrumentim (S3684)	Aparaturë e re
7	QKSKUK	Protetikë Stomatologjike	Proteza mbi implante (S3404)	Evidentuar
Njesia	Klinika/Njesia	Emërtimi i shërbimit të ri/konsoliduar	Viti	Koment
Sp Prizren	Kardiologjia Invazive	Pacientët spitalor	2025	
Sp Prizren	Kardiologjia Invazive	Echo kardiologji	2025	
Sp Prizren	Kardiologjia Invazive	Koronarografi	2025	
Sp Prizren	Kardiologjia Invazive	Stent	2025	
Sp Prizren	Kardiologjia Invazive	EKG	2025	
Sp Prizren	Kirurgjia maxillofaciale	Pacientët spitalor	2025	
Sp Prizren	Kirurgjia maxillofaciale	Pacientët ambulantor	2025	
Sp Prizren	Kirurgjia maxillofaciale	Pastrim i plagëve	2025	
Sp Prizren	Ambulanca Onkologjike	Pacientët ambulantor	2025	
Sp Prizren	Ambulanca Onkologjike	Injektimi i hormoneve tjera	2025	




Sp Prizren	Ambulanca Onkologjike	Infuzion i terapisë antikanceroze	2025	
Sp Prizren	Ambulanca Onkologjike	Administrimi i medikamenteve	2025	
Sp Prizren	Radiologji	MRI	2025	
Sp Prizren	Salla Oftalmologjisë	FAKO	2025	Aparatura ardhur 29.11.2024
SP Gjilani	Ortopedia	Sutura e manzhetës rotatore	2025	Furnizim me material osteosintetik
SP Gjilani	Fiziatra	Shtrat fizioterapeutik	2025	-
SP Gjilani	Urologjia	Urethrotomia interna	2025	-
SP Gjilani	Ambulanca Specialistike	EMNG/EP	2025	-
SP Gjilani	Ambulanca Specialistike	Timpanometri	2025	-
SP Gjilani	Ambulanca Specialistike	Doppler	2025	-
SP Gjilani	Ambulanca Specialistike	ECHO	2025	-
SP Gjilani	Interne	Venepunksion	2025	-
SP Vushtrri	Sëmundjet e brendshme	Ambulanta Specialistike Neurologjike	2025	Rekrutim i stafit të lartë mjekësor
SP Gjakovë	Laborator	HbA1C	2025	Shërbim i ri
SP Gjakovë	Neurologji	EMNG	2025	Shërbim i ri
SP Gjakovë	Amb. Specialistike	Ergometria	2025	Aparaturë e re
SP Gjakovë	Amb. Specialistike	Ultrazëri i zemrës	2025	Aparaturë e re
SP Gjakovë	Amb. Specialistike	Gastro & Kolonoskopi	2025	Aparaturë e re
SP Mitrovicë	Laboratori	D-dimer	2025	Blerje reagencash
SP Mitrovicë	Laboratori	TSH, T3, T4	2025	Blerje reagencash
Sp Pejë	Reparti i Radiologjisë	MRI	2025	Ka pasur periudhë defekti
Sp Pejë	Reparti i Oftalmologjisë	Ultrazëri i syrit	2025	Shërbim ekzistues nga 2022
Sp Pejë	Reparti i Oftalmologjisë	OCT	2025	-
Sp Pejë	Reparti i Neurologjisë	EMNG	2025	Trajnim nga IHS
Sp Pejë	Reparti Kirurgjik	Kirurgji vaskulare	2025	Proces furnizimi me material




Aneks 1: Krahاسimi i shërbimeve shëndetësore të ofruara në SHSKUK 2020-2025

Nr i Pacientëve të Shtrirë










Trend përgjithësisht në rritje me rënie të lehtë në 2023 dhe kulm në 2025.

Ditët e Shërimit




Rritje e vazhdueshme deri në 2024, me stabilizim të lehtë në 2025.







Stenta



Koronarografi

